

BIBLIOTEKA
SHTETIT

804-32

T89

KOLEC TRABOINI

Petalet
e bajames
së hidhur

TREGIME

84-52

789

KOLEC TRABOINI

PETALET E BAJAMES SË HIDHUR

BIBLIOTEKA E SHËTETIT
GJIROKASTER
~~644~~
N. INV.

3114

Tregime

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

PETALET E BAJAMES SË HIDHUR

Ne jetonim diku në një lagje të qytetit. Vërtet kishim shtëpinë tonë me një kopsht të bukur, por brenda nuk gjeje asgjë.

Unë dhe ti flinim në një krevat hekuri që nuk e di ku e kishim marrë. Në tryezën e vjetër që e mbulonim me gazeta, kishte shumë libra. Qenë librat e tu.

Atëhere kishim edhe nënën. Unë e mbaj mend kur vdiq ajo. Më kujtohet pak. Qe e sëmurë rëndë dhe më larguan prej saj. Kur u ktheva në shtëpi, të gjeta vetëm ty dhe krevatin prej hekuri bosh. Unë qava. Ti më përkëdhele dhe më the: «Mamaja ka shkuar të shërohet». Të besova, por nëna nuk u kthye më.

Atëhere ishe mësues. Ne shkonim bashkë nëpër male. Atje zura miqësi me malësorët e vegjël këmbëzbathur që i mësoje ti. Kur erdhën italianët, ne nuk shkuam më në malësi. Nxënësit mbetën pa mësues.

E dija se më doje fort. Unë po rritesha. Mbrëmjeve të gjata qëndronim pranë vatrës e më tregoje se, për të fituar bukën, punoje në një fabrikë me mëditje. Merrje ca franga. Kur kthehesha mbrë-

mjeve, të prisja te dera, prisja të më sillje diçka.

Një ditë erdhe duarbosh. Dorën e rëndë ma vure në kokë dhe më the:

— Më dëbuan, Arian.

Më fole në emër dhe mua m'u bë zemra mal.

Asaj nate dhembjen tënde e pata edhe unë. Nuk të pyeta fare, por ti më the:

— Dëgjo, Arian. Ata më dëbuan. Ata nuk duan që unë të flas për të vërtetën.

— Çfarë të vërtetë, baba?

Ishte hera e parë që më flisje shtruar për hallet e jetës. Më vështroje thellë në sy.

— Tani u rrite, Arian. Duhet të mësosh edhe ti se italianët nuk e kanë vendin këtu. Ky është At-dheu ynë, toka jonë.

Pastaj më fole për gjëra që unë i kuptoja me vështirësi.

Asaj nate e harrova fare urinë.

Ne nuk kishim bukë. Rrinim pranë zjarrit dhe flisnim për të vërtetën. Tani unë kisha një shok. Vetë ma the këtë. Më the se do të luftonim bashkë për të çliruar atdheun.

— Kur, baba? — të pyeta unë.

Sa gjëra më mësoje. Nga ti mësova t'i urreja italianët për vdekje. Ata nuk e kishin shtëpinë këtu. As i kishte ftuar njeri. Kishin shtëpinë e tyre, matanë detit. atie ku perëndon dielli.

«Unë duhet të luftoj. Po si?» Ky mendim më vlonte në tru. Qysh atëhere u mundova ta gjeja rrugën vetë.

— Arian. — më the njëherë — merre këtë letër dhe çoje te dyqani i frutave.

Unë u stepa për një çast. Të shikova. Buzëqeshe lehtë dhe më the:

— Merre, Arian. Po të zunë, gëlltite letrën. Kupton? E mora letrën dhe u zhduka. Frikë nuk kisha. Sido që të ndodhte, letra s'do të binte në dorën e tyre. Ecja dhe nëpër mend më shkonin fjalët e tua. Dikur më kishe thënë: «Edhe ne duhet të luftojmë, Arian». «Po si?» mendoja unë. Mos letrat që çoj janë fillimi i luftës! Kushedi. Pse, luftë i thonë kësaj? Po babai ç'është? Ai më ka folur diçka për komunistët. Por i këtillë nuk duhet të jetë. Komunistët janë të mëdhenj. Të fortë. I hanë italianët të gjallë... Kështu kisha dëgjuar, baba! Po Xhoxhi? E si mund të ishte komunist Xhoxhi, me trup aq të vogël? Kurrë!

Në agim dolëm në kopsht. Pranvera kishte ardhur e bukur. Bajamet qënë mbushur me lule, por vetëm lule bënin bajamet. Kokrrat e tyre qënë të hidhura. Ne qeshim. Ti thoshe:

— Që kur erdhën italianët, edhe bajamet i bëjnë kokrrat të hidhura.

Ndërsa shkelnim barin e ri dhe të lagur, më the:

— Kemi punë sot, Arian.

Të pashë në sy dhe mendoja se ç'punë mund të kishim.

Diku preke një degë bajameje. Pema u tund. Petalet ranë radhë-radhë si flutura bore. Ti qeshe. Mua më erdhi keq për lulet, po megjithatë thashë:

— Sa bukur!

Në mes të gjelbërimit të barit spikatnin petalet e bajames.

— Ç'punë kemi sot? — të pyeta.

Ti erdhe pranë meje dhe ne shikuam njëri-tjetrin në sy. Oh, kurrë s'do t'i harroj sytë e tu të hirtë, tamam si ata shkëmbinjte e zhveshur të maleve.

— Do të shkosh te xha Abdyli dhe do t'i thuash:

«Xhaxha, më jep pesë franga sot, pa nesër të sjell dhjetë». Mundohu ta tallësh, kuptove? Sikur je një rrugaç. Xha Abdyli do të të kuptojë. Vetëm kaq. Sapo ta mbarosh porosinë, eja këtu.

— Mirë, baba.

Fluturova. Pra unë luftoja. Por s'më besohej. Atë ditë pranvere bëra më tepër se dhjetë rrugë. Dhjetë porosi. Dhjetë italianë të vrarë, sipas meje. Shkova edhe te Xhoxhi. Kishte ngarkuar një sobë në kurriz dhe po e shpinte diku. Buzëqeshi dhe ma bëri me sy E kuptova. Duhet të prisja aty. U ula ndanë trotuarit dhe vështroja njerëzit.

Sa herë kalonin italianët me pupla, këndoja me vete si gjel. Kokën e ktheja në anën tjetër. Nuk i shikoja dot me sy. Se si më dukeshin.

Të nesërmen pasdite unë prisja diçka. Erdhi Xhoxhi, xha Abdyli dhe ca të tjerë që nuk i njihja. Nuk i kisha parë kurrë. Pothuajse të gjithë, kur hynin te ne, hiqnin kapelat, dhe uleshin në minder si në shtëpinë e tyre. U çudita. Ti i përqafove të gjithë me radhë. Njëri, kur hyri brenda, hoqi kapelën, syzet dhe mustaqet. Se hiqeshin mustaqet, këtë nuk e dija. Ti u afrove dhe më rrahe shpatullat sikur do t'u thoshe atyre se unë qeshë Ariani! Kishin sy të mprehtë.

— Domethënë ky qenka Ariani — tha ai që hoqi mustaqet. Ti tunde kokën. Unë u hutova. Ata më njihnin.

Dielli rrokullisej përmes lartësisë. Po errej. Në shtëpinë tonë u bënë shumë shokë. Ndoshta edhe ata nuk e njihnin njëri-tjetrin, sikurse nuk i njihja edhe unë. Kishin emra të çuditshëm. E si mund të quhet njeriu «Lis»? Rrija në oborr. Rastësisht, kur shëtisja në korridor, të dëgjoja që flisje me njërin nga ata.

Duhet të qe ai burri që hoqi mustaqet. Të fliste me zë të ashpër.

— Ta zëmë se e kapën, Bujar. Sipas teje do t'u bëjë ballë atyre?

— Kam menduar edhe për këtë.

— Çfarë?

— Nuk tregon ai.

— Por nuk është e lehtë, Bujar. Duhet menduar mirë. Rrezikon jetën e tij.

Dëgjoja, por nuk e kuptoja për kë e kishin fjalën. Ndoshta flisnin për atë djalë që dukej si student. Ti ngulje këmbë. Për kë pra? Çuditësia. Kujt ia kishin frikën se do të tregonte?

— Po ai është fëmijë — tha ai burri.

U drodha. Mund që të flisnin për mua.

— I vogël?! Vërtet i vogël, por është i përgatitur. Kam besim — ngulje këmbë ti, baba.

Haja veten me dhëmbë. Në qoftë se ata nuk më besonin, si do të luftoja unë? Më dukej vetja si një gjethe që zbret nga pema duke u dridhur nga era që fryn.

Po unë nuk do të tregoja edhe sikur të më vrisnin.

«Thuaji, baba. Ti më ke provuar sa herë. Apo jo»,
Dëgjoja prapa derës.

— Në qoftë se këtu jemi dhjetë revolucionarë, i njëmbëdhjeti është im bir — the ti.

Ata heshtën. Nuk e dinin se unë dëgjoja prapa derës, nga sytë më rridhnin lot. Lot të nxhtë. Sepse edhe unë duhet të luftoja. Folën prapë. Dikush tha «Revolucionari i vogël». Nuk e di me ç'kuptim e thanë. Ai burri që pat hequr mustaqet, e pranoi më në fund. Dolëm në korridor. Më shikonin. Ti ishe brenda. Hyra në dhomë. T'u hodha në krahë dhe të

putha fort. S'të kisha puthur kurrë ashtu. U çudite kur pe lotët e mi. E dije se unë s'qaja kurrë, ndaj më the:

— Ndonjë ditë do të vemi në mal, do të luftojmë të dy bashkë.

Nuk do t'i harroj kurrë këto fjalë. Ç'është e vërteta, më vonë dola vetëm në mal. Pa ty, baba. Ama e ndjeja se në gjoks më rrihnin dy zemra. Edhe zemra jote.

Po zbriste mbrëmja mbi qytet. Hija e një ndërtese u shtri deri te shtëpia jonë. Nata ra. Net të zymta binin mbi shtëpitë. Monotoninë e shtonin varavingat e ushtarëve që patrullonin natën. Patrullat e vdekjes.

Shokët bënin mbledhje. Dy veta ruanin jashtë. Studenti dhe unë. Atje brenda bëhej mbledhje. Bëhej luftë e heshtur. Pa krisma. Krismat e kësaj lufte do të ndiheshin më vonë. Kështu më thanë. Shëtisja nëpër kopsht. Muret ishin të larta. Vështroja çdo skutë. Shkoja edhe te studenti. Fshihej pas mureve ai. Njëherë që desha t'i flisja më këshilloi. Nuk i fola më. Mbante një pushkë të çuditshme, të shkurtër. Kishte edhe revole. Unë s'kisha armë. Qe pranverë dhe nuk bënte ftohtë. Vonë doli hëna. Ajo nxori syrin e saj të zbetë.

Petalet e bajames përpëliteshin në erë dhe hëna i zverdhte ato. Petalet lëkundeshin. Bajamja dukej si një pemë me lule të arta.

Oh, ata yjtë e largët e të ftohtë që vezullonin diku në largësitë e pafundme. Doja t'i zija me dorë. Desha t'i zbrisja nga qielli dhe t'ua falja shokëve. Yllin më të madh do ta vija në kapelën e vjetër që ma kishe falur ti, baba.

Bënte ftohtë. Ruaja jashtë mbi mur. Aty ku hëna nuk e shihte trupin tim. Përgjoja. Shpesh harroja

bukurinë e natës. S'më takonte të sodisja natyrën. Duhet të ruaja. Bëhej mbledhje. Qe lufta ime, jotja, e shokëve të tu. Lufta e të gjithëve. Unë isha i vogël dhe mora pjesë në revolucion. Isha revolucionari i vogël i babait.



Ku ta dija se luftonit atë ditë! Qe pasdite. Isha shtrirë në kopsht dhe ndjeja erën e këndshme të tërfilit. Mësoja. Papritmas dëgjova krisma. Lashë librin mbi bar dhe renda. Rruga qe e heshtur. Ku të veja? M'u kujtua se, përpara se të ikje, më pate përqaftuar fort. Një gjë të tillë e bëje çdo ditë. Kur krismat u shtuan, parandjeva se njëri nga ato krisma e nxirrte pushka jote. Po. Duhej të luftoje. Po kë luftonit? Përse tani ditën? Më pate thënë se aksionet më mirë bëhen natën, kur armiku ka vetëm veshë dhe frikë.

Edhe unë kisha luftuar këto ditë, por pa pushkë. Luftoja me trakte, sepse edhe traktet buçasin si pushkët. Traktet i shtinin dridhmën e vdekjes armikut.

Në çast u rrëqetha. Tani unë kisha detyrën time. Brenda në shtëpi kishim materiale që duheshin fshehur. Ti më kishe mësuar se si duhej të veproja. Maqina që shtypte trakte qe e rëndë. Ku ta fshihja? Andej nga fundi i kopshtit nuk qe e sigurt. Mbylla derën dhe shkova tek Iliri, me të cilin shpërndanim traktet. E gjeta në shtëpi. Të gjithë kanë frikë në fillim. Nga larg dëgjonim bomba.

— Sikur lufton një ushtri, Arian — më tha Iliri.

I tregova për maqinën, por ai heshti. Kishte ngulur sytë diku dhe mendonte. Dukej si një burrë i madh.

— Po sikur ta futim në qyemez in e Selimit?

— Kam frikë se mos e gjejnë, Ilir — i thashë.

— Nuk tregon Selimi.

— E ku e di ti? — e pyeta me dyshim Ilirin.

— I kanë marrë djalin e vetëm. Është me ne, Arian.

Duke dëgjuar krismën, ne bëmë planin tonë. Ti luftoje, baba. Edhe unë luftoja me ty. Sa herë më kishe porositur për shaptilografin. Unë e kreu porosinë tënde. Askush, përveç Ilirit, nuk e mori vesh ç'u bë shaptilografi komunist. Më vonë ata e kërkuan. Bastisën shtëpinë, por nuk gjetën gjë. Gërmuan kopshtin. I prishën edhe trëndafilët që kishim mbjellë bashkë. Edhe muret i shembën. Edhe çatinë. I pashë. Isha fshehur diku dhe përgjoja. Ata qenë si kafshë. Gulçonin. Atëhere e kuptova që kishin frikë nga ne. Kishin frikë edhe nga shaptilografi, baba.

Unë dhe Iliri u fshehëm. Nuk i ra kujt ndër mend për dy fëmijë që mbanin plaçka me karrocë dore. Ama edhe Selimi, po ta dinte, nuk do të tregonte.

Dukej se krismat nuk do të pushonin kurrë. Po binte nata. Nuk e dija ku luftoje ti. Qyteti që ngrihur i tëri, por ata kishin bllokuar rrugët.



Kur dielli perëndoi, krismat filluan të rralloheshin. Luftuat aq orë! Nuk e di cilin kishe afër atë

ditë. Xhoxhin? Burri me mustaqe falso me siguri qëndronte pranë teje. Dhe fliste me ty. Të gjithë e kuptuan dhe thanë: «Lufton Partia Komuniste! U ngrit në këmbë një popull i tërë!»

Unë isha larg. Larg dhe i vogël, baba. Po të kisha pushkë, s'do mend që do të vija aty. Sikur edhe një të vrisja. Fashistët qenë me qindra, por kishin frikë.

Krismat u rralluan. Menduam se tani do të errej dhe ju do t'i pushonit të shtënat. Por jo. Qielli ndenji i kuq tërë natën. Perëndim që nuk perëndon kurrë, baba.

Qiellin e skuqët ju. Shtëpinë ku luftonit e dogjën fashistët. Luftonit të mbuluar me gjak dhe me flakë.

Hëna doli shumë vonë. Ndoshta kishte frikë nga zjarri që digjte natën qytetin tonë. E si do dilte kur dielli kishte mbetur pezull diku pas maleve? Tërë natën ndenja mbi avlli. Më duket se ju vazhdonit akoma mbledhjet tuaja. Tej skuqin flakët e asaj kështjelle të vogël ku luftuat ju.

Zjarrfikësit erdhën ndanë kështjellës. Dëshën të shuanin flakën. Po nuk mundën. I silleshin kështjellës kot.

Sa vapë bëri asaj nate! Nuk i shikova yjtë, për të cilët ëndërroja aq shumë. Ata tani qenë të zbetë dhe të përgjakur. Mendova se armiqtë deshën të shuanin edhe yjtë. Dëshën, por nuk mundën. Edhe diellin që po vinte donin ta shuanin. Po ku shuhet dielli. Ti më ke thënë se dielli është i përjetshëm. Vërtet e mbulojnë mjegullat ndonjëherë, por ato davariten shpejt. Dielli ka fuqi. Ai djeg. Dhe donin ta shuanin. Çudi! Sa të çmendur qenë!

Rrija mbi avlli asaj nate. Ishte nata më e gjatë e jetës sime.

Më vonë komunistët më thanë se kisha luftuar edhe unë. U çudita pak.

— Po, po — më thanë.

Më deshën shumë komunistët. Pastaj dola partizan. Dola vetëm, baba. Ti nuk erdhe dot. Kishe marrë aq plumba asaj nate!



Erdhi pranvera e re. Bajamja përsëri çeli lule e kokrrat i bëri të ëmbla, por pranë saj nuk të pashë ty.

Ndjeva veç zemrën tënde të madhe që u ndodh kudo. Pranë çdo bajameje e pjeshke. Se ti i doje lulet. Dhe në qoftë se asaj dite shkunde bajamen, saqë petalet ranë përdhe mbi barin e vesuar, ti e bëre këtë jo pa qëllim:

Nuk doje që pranverat tona të lidhnin frute të hidhura.



PLAKU

Shtegu vinte i ngushtë sa mund të kalonte vetëm një njeri. Pushkën e mbante në ndorë. Dëgjoji diçka që lëvizi, por s'pati kohë të merrte vesh çfarë ishte, se një peshë e rëndë iu hodh mbi kurriz.

Plaku hoqi koburen dhe ia drejtoi kundërshtarit, por plumbat fluturuan pa zënë në mish. Pastaj futitë e lanë.

«Shtatëdhjetë e pesë vjet për një burrë janë shumë», tha për herë të parë në jetën e tij, kur e pa veten të lidhur. E morën përpara dhe e çuan në kullën ku ishte komanda e pushtesve.

«Të bukur kuvend mblodhe, o Marka Gjoni,» — tha plaku me vete, duke shtrënguar nofullat. Përballë i doli një kapiten i ushtrisë së huaj.

— Kush je ti që shëtit në male?

— Shqiptar.

— Ç'e do pushkën?

— Shqiptari pa pushkë është si zogu pa krahë.

— Si e ndjen veten?

— Keq — tha plaku duke lëvizur krahët e tij të lidhur me litar. Pastaj shtoi;

— Por jo edhe aq keq.

Oficeri iu afrua dhe i tha të rrinte në një stol

druri që kushedi se kush e kishte gdhendur. Si do të ulej në drurin e tokës së tij i lidhur? Qëndroi më këmbë në mes të dhomës i ashpër, sikur tiparet t'i kishte prej guri, si një shkëmb që vetëm rastësisht qe shkëputur nga mali.

— Si e ke emrin? — e pyeti oficeri.

— Shqiptar, e thashë një herë.

— Dëgjo, shqiptar — tha oficeri. — Ne jemi aleatë. Ju jeni pak, kemi ardhur t'ju mbrojmë.

— E di — tha plaku.

— Kasollet tuaja do t'i mbrojmë ne. Ju vetëm arat dhe bagëtitë shikoni.

— Edhe këtë e di — tha plaku. — Po ky karakoll na kushton shtrenjtë, e nuk kemi si ta paguajmë veç me plumb. Ju kërkoni atë që kushton më shumë se buka dhe mishi.

Oficeri, pasi e zgjidhi plakun, i zgjati kutinë e duhanit, të cilën robi nuk e mori.

— E pimë të fortë ne, shqiptarët.

— Po kur nuk ka të fortë?

— Barut — tha plaku. — Barut.

— Trimat ku i ke?

— Malit.

— Do të të le të lirë, po t'i sjellësh këtu.

— Çdo mish varet në çengel in e vet.

— Thuaju një herë. Në ardhshin, të falur janë.

Plaku mendoi se mbase i vinte rasti t'u ikte armiqve, por më pas qeshi me mendimin e tij.

— Pushkën — tha plaku.

— S'ka ç'të duhet, të mbrojnë ushtarët e mi.

— Edhe këtë e dija — tha plaku.

Ndjeu diçka në shpirt. Vendosi të shëtiste pak kohë nëpër male. Le të çmallej, se nuk i dihej ç'do të ndodhte. U nis me hap të lehtë përmes shkëmbinjve.

I çarmotusur. E para herë që prej pesëdhjetë vjetve që alltia e tij nuk ndodhej në brez, por në duart e të huajt. Plaku i thinjur ecte lehtë përmbi gurët që të mos i lëndonte. I dukej se edhe shkëmbi ndjente dhembje. Kudo të huaj. Mbi këtë tokë të vafër vërshuan mijëra ushtarë që t'ia rrëmbenin të vetmen pasuri, lirinë.

Dy pushtues ecnin pas tij. Të tjerët përgjonin diku larg që t'i zinin shqiptarët në befasi. Plaku mendoi për trimat e tij që i kishte lënë në një fshat pas malit. Ata prisnin një njeri që s'do të kthehej kurrë. Iu kujtua se ku qe ndarë me të katër malësorët. Njeri nga ata, më trimi, kishte dashur t'i vinte pas. Plaku diçka kishte ndjerë në shpirt dhe kishte vendosur të shkonte vetëm në kuvend. «Ata shpëtuan për mrekulli. Janë të rinj e trima. Pushkën nuk e ndajnë nga vetja, gjersa të bien një ditë. Unë kam jetuar mjaft. Ohu, shtatëdhjetë e pesë vjet nuk janë pak. Njëzet e dy në Vraninë me Oso Kukën, edhe një herë aq në Zharnicë. Le luftën e Vrakës ku malësorët luftuan rreptë, por u thyen keq. Të mos ishte tradhëtia e krerëve të Shkodrës, ngjarjet nuk do të rridhnin ashtu.»

* * *

U ndal diku. Ushtarët hapën sytë, por, kur e panë tek ulej rrëzë një dardhe të egër, u qetësuan. Qëndronin përballë tij. Kishin frikë. Oficeri u qe betuar se, po t'u ikte plaku, do t'i vriste. Po plaku nuk kishte ndër mend të ikte. E ku? Mali qe rrethuar kudo me armiq. Më mirë t'i qëndrosh armikut përballë, se sa të shpëtosh si frikacak.

Nxori çibukun e dashur që ia kishte falur një plak njëqind vjeç. Plakut kelmandas, kur ishte i ri, ia kishte falur një plak nga Dukagjini. Ka kohë. Atëhere ishte i ri dhe bridhte shkrep më shkrep me mauzer krahut, se ndiqej nga koshadhet e turkut. Hej, sa kohë kaluan! Kurrë s'e hoqi mauzerin nga dora dhe nuk e humbi çibukun.

Thithi fort duhanin e ofshani kur mendja i shkoi te liria që nuk e gëzoi kurrë. E pra shumë qenë vrarë për lirinë. Nga i gjithë vendi, veri e jug. Disa vjet para se të ngrihej flamuri, ai hyri te valiu i Shkodrës me kërkesat e malësorëve. Bedri Pasha desh ta blente me dymijë lira ari. Por nuk kishte Turqia aq para sa t'i blente malësorët. Ne deshëm vetëm lirinë. Ne luftuam. Qe e gjatë kjo luftë. Ne ngritëm flamurin, fituam lirinë, të cilën nuk e gëzuam dot. Pa mbushur tre vjet, vërshuan ushtarët armiq. Po përse? Kë kishin vrarë shqiptarët dhe tokën e kujt kishin shkelur?

* * *

Nga grykat nisi të frynte një erë e ftohtë. Hodi sytë rreth e rrotull. Iu duk se dëgjoi një zile bagëtish, diku matanë pllajës. Nuk i zuri syri asgjë, veç një fjolle të kaltër tymi që merrte përpjetë drejt qiellit. Plaku u ngrit dhe, pasi kundroi tërë hapësirën e maleve, u nis. Ushtarët diç i thanë në gjuhën e tyre, por ai nuk ua vuri veshin. Arriti në kullë kur po vinte mbremja.

Rrapi i madh në oborr fëshfërinte lehtë.

— Nuk i solle, o plak?

— Malet nuk shkulen.

Oficeri u tërbua nga inati. Malësori trim rrinte i qetë përballë tij. Më tej ushtarët.

— Po unë do t'i shkul.

— Provoje — tha plaku.

— Ti e do jetën?

— Si nuk e dashkam? Po përse kam luftuar unë? — tha plaku.

— Në u vrafsh, a të dhimbset jeta?

— Pak. Bile aspak.

— Po ç'të dhimbset ty, o plak i marrë?

— Toka — tha plaku. Pastaj shtoi: — a e di ç'është toka?

— S'ka më tokë për ju, është toka jonë — gërthiti oficeri.

Malësori qeshi.

— Kështu thanë edhe turqit, po shiko rreth e rrotull, ku janë?

Oficeri picërroi sytë e tij të vegjël. Plaku foli përsëri:

— E pra, ku janë?

— Në Turqi — u ngut oficeri.

— Gabohesh. Pse në Turqi? Pa ngreje pak atë gurin që ke nën këmbë. Hë de, ngreje. Zgjate dorën dhe preke tabanin e ftohtë. Nuk e ndjen frymëmarrjen e të vdekurve? Ka shumë kocka njerëzish kjo tokë. E thua pastaj se paskan shkuar në Turqi! Si shkuan? Kur? Ti nuk e di ç'është toka, o pushtues.

Plaku nuk pranoi t'ia lidhnin sytë. Shkoi vetë pranë rrapit që fëshfërinte dhe priti. Ishte i vetmi shqiptar që zunë të gjallë, e edhe këtë me tradhëti, Të tjerët kishin shkuar nëpër guvat e maleve dhe luftonin.

I shkoi mendja te trimat e tij që kishte lënë në

fshatin e largët. Atyre do t'u vinte keq, por do t'ia merrnin hakun.

Oficeri thirri një skuadër dhe e vuri disa hapa larg malësorit me flokë e mustaqe të bardha, të cilat ia ledhatonte freskia e buzëmbremjes.

— Ç'do të thuash, o plak?

Malësori filloi të fliste ngadalë. Pastaj fjalët morën vrull dhe oficerit iu duk se nga malet rrokulliseshin ortiqe e vendi shungullonte në një përmbysje vigane. Sikur vërshonin lumenjtë dhe shembeshin malet.

— Dëgjo, o pushtues. Ikni prej maleve tona para se ato t'ju zënë nën vete. Për ju ajri nuk ka jetë dhe toka nuk jep bukë. Zogjtë e maleve tona nuk cërojnë për ju. Ikni! Dielli ynë ju djeg e krojet e maleve tona ju helmojnë. Në i paçi shpresat në ndonjë kullë si ajo e Marka Gjonit, mos shpresoni shumë. Si kulla e Oroshit janë pak. Edhe ato që janë, u shofshin!

Oficeri u largua. Mustaqet e bardha të plakut u drodhën paksa. Nuk i vinte keq se vdiste. Jo. Shumë zjarr kishte parë në jetën e tij.

Dëgjoi fëshfërimën e fletëve të rrapit dhe hodi sytë tutje në horizont. Tejpërtej male. Përsëri male. Thua brengat e kësaj toke të qenë ngurosur si revoltë ndaj padrejtësisë së shekujve? Male.

ITALIANI DOMENIKO

Qe një mbrëmje e vakët. Nga jugu vinte një erë e butë dhe ledhatuese që shushurinte lehtë përmes gjetheve. Yjet vezullonin në qiellin e errët. Ndonjë, në të rrallë, shuhej duke lënë prapa një shirit të shndritshëm që dukej sikur zbriste deri mbi çatitë e përgjumura.

Xha Sheroja dhe italiani ecnin në një rrugicë të ngushtë, pa i folur njëri-tjetrit. Plaku ecte përpara. I dyti dukej se kishte frikë. Pandehte se nga çdo skutë mund t'i dilte gryka e ndonjë automatiku gjerman.

«Po ç'rëndësi ka se kush të qëllon», mendonte ai. «Të gjithë plumbat vrasin njëlloj dhe, kur vritesh, nuk ke kohë të pyesësh se i ç'marke qe automatiku.»

Atë do ta vriste lufta dhe pikërisht, se urrente luftën, shkante prapa plakut shqiptar për të çminuar minat që kishin lënë gjermanët.

Xha Sheroja e njihte vendin mirë.

Hynë në një oborr, të errët. Këmbët u shkelnin mbi barin e ri që sapo kishte dalë.

— Hë, djajtë! E kanë mbyllur me dry.

— Gjermanët? — pyeti italianin.

— Kush tjetër veç tyre?

Domenikoja mendoj. Mallëkoi veten dhe gjerma-
nët. I dukej se në çast, të gjitha minat mund të shpër-
thenin.

— Ç'ke? — pyeti plaku.

— Unë? Asgjë. Se si më erdhi.

Dritarja që me dy kapakë të vjetër druri. Ita-
liani iu afrua dritares dhe shikoi me kujdes çdo kënd.
Nuk dukej ndonjë fije teli. Se ku e gjeti gjithë atë
forcë në vetëvete dhe theu një copë dërrasë, pastaj
dhe një tjetër, gjersa u hap dritarja. Plaku desh të
hynte vetë i pari, por Domenikoja nuk e lejoi.

Italiani, përpara se të hynte në dritaren e frik-
shme, shikoi yjet. Plaku i dha kurajë.

— Këto janë të tmerrshme — i tha italiani xha
Sheros që vështronte arkat e minave.

— E paskan bërë si Ali Pashaj — tha plaku.

— Çfarë? — pyeti italiani.

Xha Sheroja u kthye dhe e pa.

— Pak kanë vrrarë gjer tani — foli duke ecur
drejt arkave.

Xhenieri italian iu hodh dhe e tërhoqi prapa me
forcë, saqë e përplasi diku, pas murit.

Plaku u nxeh.

— Tfu! Djalli të marrtë!

Italiani, pasi e ngriti, i foli lehtë:

— Desh na hodhe në erë.

— E përse?

— Nuk i pe telat, xha Shero?

— Pse, o, telat të hedhin në erë?

Mbi dysheme dukej një tel i hollë që ndante je-
tën nga vdekja me një kufi milimetrik. Sapo ta prekte
dikush, do të buçiste si një mal që shembet.

Xhenieri Domenico mendonte me sytë ngulur mbi arkat e municionit që ndriçoheshin zbetë nga drita e verdhë e fenerit. Mendonte për depon e minave, ku djalli vetë nuk do të merrte guximin të futej, se gjente vdekjen më të tmerrshme. Të vdesësh dhe të mos të gjente as nami, as nishani. Këtë lloj vdekjeje e shoqërojnë vetëm oshëtimat shkatërruese.

Një minë si këto ia kishin zhdukur familjen për pak sekonda, madje as varre nuk kishin. Italia nuk kishte dhënë asnjë pëllëmbë tokë për dy djemtë dhe gruan e tij. Po ç'fliste! Varrosen buçimat? Ama këto mina duhej t'i çminonte. Duhej. Xha Sheroja nuk kishte frikë edhe xhenieri nuk duhet të ketë frikë, megjithëse gabon vetëm një herë në jetë.



Një natë xha Sheroja e përcolli deri te shtëpia e vjetër dhe, pasi italiani u zhduk në kasollen e vdekjes, plaku e pyeti:

— Ato kapsollat ku i ke, more bir?

— Ja, këtu, xha Shero.

Italiani kishte sjellë ndezësit.

— Do t'i marr me vete t'i fshih — i tha plaku, mirëpo pastaj seç iu kujtua. — Dëgjo, Domenik. Sonte po shkoj në fshat, se kam një vëlla të sëmurë. As nesër nuk vij, por ti mos u mërzit, ha e këputja gjumit.

— Po më the një herë, xha Shero.

— Ptfu, djalli e mori! Plaku harron shpejt, por ne jse, ki kujdes. Punë të mbarë, biro!

Plaku që zhdukur nëpër dritaren e prapme që

dilte në kopsht dhe Domenikoja kishte filluar nga puna. Disa nga veglat e çminimit i kishte punuar vetë, se ia dinte mirë zanatit. Ç'është e vërteta tani nuk kishte frikë, sepse punën më të rrezikshme e kishte përfunduar, mirëpo për dreq, gjermanët të gjitha minat i kishin lënë të gatshme. Ndoshta e kishin bërë me qëllim; ai që do të hynte i pari, do të fluturonte me gjithë lagjen. Ndoshta. Italiani Domeniko qe mësuar me minat. Tërë jetën qe marrë me to. Madje shpesh punonte pa kujdes. I merrte dhe, pasi u vendoste telin siguruës, u hiqte ndezësit. Se ndezësit, ndezës qenë dhe e kishin për detyrë të pëlcisnin në çast, pastaj s'do të kishte kohë të mendonte se si plasën dhe ç'gabim bëri.

Filluan t'i rridhnin djersë. Ishte natë.

Sytë i lodheshin. Ditët e para nuk u mësua dot, mirëpo më vonë, flinte ditën dhe punonte natën për mrekulli.

Mirëpo atë natë qe i mërzhitur. Sa herë që i shkiste dora, një e dredhur e lehtë i kalonte në trup. Sa herë qe dredhur kështu. Kur ishte minator, në guroret e Italisë, kishte parë tmerre më të mëdha. Kjo s'qe gjë fare. Në këtë shtëpi të vjetër mund të vdiste vetëm një njeri, ndërsa atje qenë vrarë me dhjetëra, pa qenë kohë lufte.

Mendimet i vinin dallgë-dallgë, tamam si ato trumbat e reve në muzgun e një mbrëmje të zymtë. I dukej se ngjyra e kuqërremtë e reve vinte nga gjaku që ishte derdhur aq shumë në këto vite. Ndoshta qenë skuqur edhe nga gjaku i dy fëmijëve të tij të vrarë. Mundet. Në Itali ishin vrarë shumë fëmijë.

«Eh, Domeniko, i thoshte vetes, sa larg ndodhesh. As qiellin e kaltër të atdheut ndoshta nuk do të

shohësh. Lufta, Domeniko, kjo luftë që të-mori djem-të. Këtë luftë duhet të mallëkos!».

Kur mendonte kështu, xhenieri donte ta mbaronte punën brenda një nate, prandaj, pas pak, në kutinë e drunjtë, qenë mbledhur aq shumë ndezës, saqë një punë të tillë s'do ta kishte bërë dot as për dy net të tjera.

I dukej se lufta varej në duart e tij. Sa më shpejt t'i çminonte këto të mallëkuara.

Mirë këtu, po në atdheun e tij ç'po bëhej? I vinte ndër mend shtëpia, diku mes Alpeve të Italisë. Punonte në gurore dhe i jepnin pak lireta, aq sa të ushqente fëmijët. Nuk i bëhej vonë që po përgatitej lufta.

Ç'i duhej lufta atij? Atje në Veri askush nuk do ta trazonte. E kush ka nevojë për një minator pa shkollë? Vetëm familja dhe pronari. Nxirrte gurët dhe gurët për Domenikon qenë bukë.

I patën thënë njëherë:

— Ti duhet të hysh në partinë fashiste.

Ai kishte menduar. Para tij qenë ca burra të shëndoshë, tamam si pronari.

— E çfarë më sjell partia juaj?

— Një Itali të madhe dhe të fuqishme.

Domenikoja i kishte shikuar në fytyrë. Ato qenë të bardha dhe të majme.

— Mua çfarë më sjell?

— Këmishëzinjtë qenë larguar. Një punëtor i ri i kishte thënë minatorit:

— Ne kemi partinë tonë.

— S'kanë ç'më duhen partitë, Tonino. Unë dua të ushqej fëmijët.

Toninoja kishte heshtur. Urinë e Domenikos e kishte dhe ai.

— E ke parë pronarin sa i shëndoshë është?

— Po.

— Ai ushqehet me djersën tënde, Domenik. Ti je njeri dhe jo skllav.

Minatori i kishte rrahur krahët Toninos. Uria nuk i jepte kohë të mendonte se ç'ndodhte në botë. Ai kishte dy fëmijë dhe gruan. Kaq i mjaftonte.

— Unë jam i uritur, Tonino. Politika s'ma shuan urinë. Mirëpo edhe në Alpet e Italisë erdhi lufta. Minatori pa me sytë e tij ngjarje të përgjakshme. Punëtorët bënë grevë. Fashistët e shtypën grevën. Gjak në vend të bukës. Një gjë të tillë minatori Domeniko s'e kishte dëgjuar kurrë. Por ja që ndodhi. Fashistët masakruan edhe minatorin e ri, Toninon. Domenikoja qau atë ditë. Qau për një italian të uritur që e nxirrte bukën me krahë.

Kështu mendonte xhenieri i huaj ndërsa çmi-nonte. Kujtonte çdo gjë të kaluar. U lodh dhe la punën. Pasi hoqi ndezësit në një anë, u ul të pushonte pak. Djersët i kullonin në fytyrë. I bëhej se aty, mbi arkat e minave, shihte Toninon e torturuar. Pastaj Toninon e kishin vrarë.

«Hej, Tonino, Tonino! Unë tani ndodhem larg atdheut. Ata e kthyen italianin, baba me dy fëmijë, në xhenierin Domeniko. M'i veshën rrobet ushtarake dhe më varën një medalion. Ushtari është vetëm trup. Në qoftë se gjer atëhere s'më interesonin partitë dhe politika, më vonë s'më interesonte asgjë. Unë, minatori Domeniko, isha kthyer në një kufomë në uniformë dhe më dërguan të vrisja njerëz në Shqipëri. Por, jo Tonino. Unë nuk vrava. Këtu në këtë vend të çuditshëm gjeta njerëz të mirë. Xha Sheroja më mbajti dhe, kur unë i tregova për ty, më tha:

«Po ju nuk e mbrojtët? Nuk luftuat? Ej, ç'djalë paskan vrarë, qafirët!»

«Dhe e di si erdhi fundi, Tonino? Fundi për të cilin më kishe folur aq shumë.»

Ishte mbrëmje shtatori. Vetëm një lajm. Kapitullim. Mbi kokët tona filloi të sillej fantazma e vdekjes. Ç'do të ndodhte më tej? Robërit e kujt do të ishim? Klithmat dhe ulërimat e ushtarëve përplaseshin në dyert e komandës ku oficerët qenë mbledhur kokë më kokë. Shanë Duçen dhe të ëmën e tij që e polli. Porko Dio. Një ushtar piemontez tha se shqiptarët na kishin bërë thirrje për t'u hedhur në mal. Dikush dyshoi. Oficerët mund të na dorëzonin te gjermanët. Secili nga ne ra në heshtje duke menduar për fatin që e priste. Ç'do të thotë kjo?

Në mesnatë dëgjuam ulërima të tmerrshme. U ngritëm tërë frikë. Ishte një lombardas. Gjuante me gurë dritaret e komandës dhe kërkonte ta çonin në shtëpi. Oficeri i tha të pushonte.

«Ju do të na dorëzoni te gjermanët!» bërtiti ushtari i xhindosur.

«Hesht, frikacak!» i tha oficeri duke nxjerrë pistoletën. U zunë. Pastaj çdo gjë rrodhi shpejt. Oficeri qëlloi dhe ushtari u tulat duke vështruar yjet dhe profilin e gjatë të vrasësit që lëkundej në një pellg gjaku. «Të ikim», tha dikush. Frika se gjermanët po vinin më shtyu të vrapoja drejt kodrave me ullinj. Brodha gjithë natën nën yje. Pastaj u shtriva diku. Kur hapa sytë, kishte lindur dielli. Mbi kokën time qëndronte një fytyrë plot rrudha dhe me një vështrim të dyshimtë. U ngrita. Rrudhat e plakut lëvizën dhe ai tundi kokën lehtë. «Hë. U shpartalluat? Mirë ju gjeti. Nuk morët mend në njëzetën?» Ai plak i

guditshëm shqiptar tundte kokën dhe ashtu i kënaqur siç qe më dukej triumfator i vërtetë.



Xha Sheroja kishte ardhur në shtëpi dhe nuk e kishte gjetur italianin. «Ku do të jetë?», mendoi. U nis drejt vendit ku ndodheshin minat. Qe mëngjez. Duke ecur përmes barit të vesuar, plaku linte pas vetes gjurmat e opingave të mëdha.

«Mos e ka zenë gjumi», mendoi, ndërsa po hapte derën, menteshat e së cilës bënë një zhurmë rrëqethëse. Hyri brenda. Errësirë. Nga dritarja hynte një tyl i bardhë drite, që sa vinte e tretej në errësirën e dhomës. Arkat ishin po atje. Asgjë nuk kishte lëvizur. Kur iu mësuan sytë me errësirën, pa se atje, në qoshk, mbi një postiqe, rrinte një njeri i kërrusur, me kokën mbledhur në grushte.

— Domenik! — i foli lehtë.

— Hë. . .

— Po flije?

— Mendoja — tha ai duke u ngritur në këmbë. Në fytyrën e tij plaku dalloi një shprehje dhembje.

— Ç'ke Domenik?

— Asgjë, xha Shero.

— Përse s'ke shkuar të flesh? Ke ndenjur tërë natën në atë qoshk me lagështirë duke menduar. Diçka ke.

Italiani nuk foli.

— I ke çminuar të gjitha?

— Po.

— Hajde të vemi në shtëpi.

Mbyllën derën dhe u nisën. Me të hyrë në shtëpi, xha Sheros i erdhi pranë qeni i vogël leshtor që i përkëdhelej pas këmbëve.

Plaku mbushi një tas qumësht dhe ia zgjati italianit. Ai nuk e mori. Tha se nuk kishte uri.

— Pije, se të bën mirë!

— Nuk dua. Nuk meritoj asgjë. Një shok më tha se gjermanët kishin pushkatuar njëzet nga tanët.

— Jo. . .

— Para një jave. I kishin vënë të hapnin një gropë dhe pastaj. . .

— Vetë e kanë fajin — u inatos plaku. Domeniko hapi sytë i hutuar.

— Askush nuk u tha t'u dorëzohen gjermanëve. Të shkonin në mal. Im nip është partizan. E di ç'më tha? Italianët kanë formuar një batalion partizan që lufton maleve. Dhe janë trima. Kur lufton për liri, njeriu bëhet trim. Edhe unë kam luftuar në njëzetën.

Xha Sheroja u ngrit, mori sqeparin dhe doli në oborr. Kishte për të bërë ca bishta sëpate. Qeni leshtor i vinte kudo nga pas.

«Po ik, or djall!» tha duke e shtyrë tutje.

Qeni kuiti dhe hyri brenda. Xha Sheroja vështroi nga dritarja. Domeniko rrinte në mes të dhomës pa lëvizur fare.

«Le të mendojë, tha me vete plaku. Njeriu që nuk mendon është si një trung lisi i djegur nga rrufeja».



Unë rri këtu në një kasolle të varfër. Një plak i mirë shtoi varfërinë e tij për të më ushqyer. Njeriu

nuk dallon dot se cila është më fisnike te shqiptarët: Trimëria apo bujaria.

Kur erdha së pari në këtë vend, i urreja. Më dukeshin të egër dhe me një shprehje të ngrirë në fytyrë. Ata na rrinin larg dhe ne kishim frikë prej tyre. Ca kohë ra heshtja. Pastaj na qëlluan. I vramë dhe na vranë.

Kur ushtria jonë fodulle u kthye në një turmë të frikësuar për vdekje, që vetëm mallëkonte dhe rendte drejt detit, ata na thanë: «Hani! Qenkeni të uritur!»

Dhe unë jetoj në këtë kasolle me bukën e qu-mështin e një plaku. E pse. Pak i fuqishëm qenkam unë?! Oh, po njeriu nuk paska vetem trup. Ndonjë-herë xha Sheroja më thotë:

«Hej, italian! Dil jashtë. Po fryn erë e detit». Unë ngjitem me këmbë e duar në rrap dhe rri me orë të tëra duke menduar. Era e lagësht më hyn në çdo pjesë të trupit dhe më duket vetja si një flamur i rreckosur. Ndjej doçkat e fëmijëve që përkëdhelin mjekrën time të parruar. O fëmijët e mi, gruaja ime e mirë.

Pastaj bie shi.

Gjer kur kështu? Thonë se shokët e mi luftojnë.

Dhe ata na pranojnë në gjirin e tyre si shokë armësh! Mos vallë urrejtja e këtij populli mori fund? Jo! Ata nuk i harrojnë të vrarët. Ky plak i mirë që i dhemben zogjtë, kur bie fjala për luftë, ngrys ve-tullat.

«Na vratë djemtë. Këtë s'jua harrojmë kurrë».

E megjithatë nuk na vranë pas kapitullimit. Urrejtja e tyre i nënshtrohet një logjike të rreptë.

«Fashizmi na mori të keqen. Do mundim gjer-manët. Doni që Italia të jetë e lirë dhe popullit t'i

hiqen prangat që i vuri Musolini? Ejani! Luftoni me ne». Ja, kështu na thonë shqiptarët. Në këto male përreth lufton një batalion me emrin e një komunisti italian. Mos është emri yt, Tonino? Ti ishe komunist dhe e urreve fashizmin gjer në fund. Unë heshta dhe humba fëmijët.

Ky është dënimi. Po ti, Tonino, ç'do të bëje, po të ndodheshe në vendin tim? Do të rrije dot në këtë kasolle të varfër në mëshirën e një plaku zemërmirë? Jo. Këtë s'do ta bëje kurrë. Automatiku yt do të buçiste në mal me batalionin partizan. Ti kurrë s'do të pranoje që të tjerët ta sillnin lirinë si një tufë lulësh të bardha me një mbishkrim urimi.

Ndërsa unë? Ptfu!.. Djalli ta marrë!

...Çdo ditë vriten fëmijë, Domeniko. Çdo ditë. Ti rri kot në dheun e huaj duke ëndërruar për qiellin e kaltër të Italisë, ku endet vdekja si një pëlhurë e ndyrë merimange. Të urresh luftën, nuk qenka çdo gjë, të luftosh vdekjen, është e gjitha.

Po të biesh, mund të varrosesh si gjithë heronjtë. Mund të hysh në zemrën e kombit dhe të rrosh përjetë. Se edhe Garibaldi ka luftuar. Dhe ishte italian i madh Garibaldi. Italian i madh, Domeniko...



Një ditë Domenikoja u ngrit herët dhe i kërkoi plakut pushkën që kishte sjellë me vete mbrëmjen e kapitullimit.

Xha Sheroja pa se fytyra e italianit ishte zbehur dhe sytë i qenë futur thellë.

«Ai përsëri ka ndenjtur pa gjumë. Përsëri ka

ëndërruar fëmijët dhe atdheun e tij të largët».

— Ç'e do? — pyeti plaku.

— Do të iki.

— Ç'të ka shkrepur të bësh?

— Asgjë.

— Mos ik — i tha plaku. — Mua s'më je rënduar.

— Nuk rri dot, xha Shero. Më dhemb, ja, këtu.

— Rri.

— Jo.

— Atëhere ik. Ç'pret. Asnjë rob lufte nuk ka të drejtë të mbajë armë.

Italiani iu afrua plakut dhe, si e pa në sy, me zë të butë i tha:

— Po më duhet, xha Shero. Nëma...

— Hej ç'më polli me këtë njeri. Ke ca ditë që nuk je në rregull fare. As ha, as fle. Shokët e tu luftojnë në mal dhe vriten, ndërsa ti do të bredhësh udhëve kot së koti. Turp! — u zemërua plaku.

— Jo kot, xha Shero — e ndërpreu Domenikoja duke vështruar lart në mal.

DROJTJE

Ndoshta kurrë nuk do të merrja guximin t'i thosha Blertës se vendlindja ime fshihej diku, në mes të Alpeve, dhe fshati im i vogël ishte mbuluar i tëri nga pyjët e gjelbëra të pishës dhe mund të shikohej vetëm me avion. Jo se fshati im qe më pak i bukur, se fshatrat e tjera të Veriut, këtë as që e vë në hesap; por nga ndrojtja se shoqëria që krijuam në ditët e para të shtatorit, mund të ftohej shumë shpejt. Këtë drojtje e pata që në njohje, kur një shok i fakultetit na prezantoi.

I thashë se isha nga qyteti S. Nuk bëra mirë. Më vonë, kur shkova në konvikt, ndjeva se kisha gabuar. Në kokë më përfytyrohej një skenë e çuditshme, sikur në mes të bulevardit endej një plakë me rrobe të zeza, e cila vinte drejt meje, por unë largohesha duke u thënë njerëzve se ajo nuk ishte nëna ime. Por plaka afrohej, gjersa në fytyrën e saj dallova rrudhat e nënës sime. Diku larg në trotuar rrinte Blerta me fustanin e kaltër dhe më shikonte thellë me ata sytë e zinj që shprehnin urrejtje.

Mendoja. Ishte natë. Shokët e dhomës flinin të qetë. Përmes dritares së hapur hynin rrezet e hënës. Në kodra plepat fëshfërinin lehtë, me një ëmbëlsi të çuditshme dhe ledhatuese.

Kjo natë e bukur që sodisja përmes dritares së konviktit më sillte ndër mend fshatin tim të dashur, të cilin unë padrejtësisht e kisha mohuar vetëm e vetëm që në sy të një vajze, të dukësha qytetar. Po përse pas kaq kohësh më bren në shpirt ky mendim? Sikur njohja ime me Blertën të kishte qenë fare e thjeshtë, s'do të më vriste ndërgjegjja, mirëpo kishte ndodhur ndryshe.

Ajo hyri në botën time me çiltërsinë më të çuditshme, mirëpo, sa më shumë rrinim pranë njëri-tjetrit. aq më tepër mbyllesha në veten time. Përse? Një pyetje të tillë ma bënin sytë e saj të zinj. Unë nuk kisha ndër mend t'i përgjegjesha.

Nga natyra jam i drojtur. Pjesën më të madhe të kohës e kaloj në vetmi, duke soditur natyrën. Sikur vetëm një copë qiell të duket, unë e vështroj me kënaqësi, duke u munduar të dalloj nuancat më të holla të ngjyrave. Megjithatë nuk marr vesh nga piktura. Sa për vargje, mund të them se kam krijuar edhe vetë. Sigurisht krijimet e mia u kushtoheshin pyjeve, maleve dhe fshatit tim të bukur, ndërsa për dashurinë nuk kam shkruar ndonjëherë. Ndoshta se nuk kam dashur ndonjë vajzë. Sidoqoftë, diçka ndjej në shpirt sonte ndërsa rri në dritare, ku ndriçojnë rrezet e hënës dhe tutje, përmes kodrave të errëta, përhapet mërmëritja e gjetheve.

o
o o

Kështu e shkrova një poezi të bukur për fshatin tim. Në mëngjez u ngrita i fundit dhe u mundova të fshihja letrat me vargje në fund të valixhes. Mbase

T. më kuptoi, sepse m'i nguli sytë e kaltër sikur do të më lexonte mendimet. Pastaj qeshi duke thënë:

— Për Blertën e ke shkruar?

Unë heshta. Kështu hesht gjithmonë kur më ngacmojnë shokët.

— Ti mblidhesh si kërmilli në guaskë — më tha një shok tjetër.

— Epo, mirë — u thashë.

— Enigmatik — më tha ai dhe shokët qeshën.

Mos vallë shokët kanë të drejtë të më qeshin?

Kjo qeshje është e sinqertë dhe unë s'mund të dal kundër saj, sepse atëhere shokët do të rrinë të ftohtë ndaj meje.

Njëherë, kur po hyja në klasë, shokët e grupit thanë:

— Po vjen një statujë.

Disa qeshën, por aq lehtë, sa që unë nuk i ndjeva dot.

Qeshi edhe Blerta. Nuk ia mora për keq askujt. Fundja ishim shokë të një grupi dhe s'kishte si të më mbetej qejfi.

Në ditët e para të shtatorit zura një vend në fund, mirëpo pas ca ditëve, pranë meje erdhi ajo. Në fytyrë i endej një buzëqeshje e çiltër, ndërsa flokët e gjatë dhe të zez i kishte lëshuar krahëve.

Në fillim Blertën e krahasova me një nimfë që erdhi papritur në bankën time, por më vonë m'u duk i pavend ky krahasim dhe mendova për diçka tjetër më të bukur.

Një ditë më tha:

— Je tepër i ftohtë.

— Jam nga Veriu — iu përgjegja.

— Edhe T. është nga Veriu.

— Po.

— Ç'do të thuash? — më pyeti.

— T. është tjetër tip, pastaj është në vitin e dytë dhe e ka krijuar shoqërinë.

Ajo heshti duke më vështruar në sy.

Sytë e saj të gjallë më shqetësuan dhe e hodha shikimin diku, përtej pishave të bulevardit.

— Edhe ti ke krijuar shoqëri — më tha ajo.

Ngrita supet. Blerta nuk m'i ndau sytë.

— Përse nuk flet? — më pyeti.

— Ç'të të them?

— Ne, a kemi shoqëri?

— Ne të dy?

— Po.

— Kemi — i thashë.

— Prandaj të jesh më i shoqërueshëm.

Pasdite kishim leksion historie. Para se të arri-
nim në qytetin e studentëve, ajo tha:

— Luan një film i bukur.

— Në kinema «Partizani»?

— Po.

— Të shkojmë pasdreke? — e pyeta.

— Mirë.

Ishte hera e parë që e ftoja Blertën në kinema. Hëngrëm bukë, dhe kur dolëm, Blerta kishte veshur fustanin e kaltër, që i rrinte mirë në trup. Flokët i hidhte sa andej — këtej krahëve.

Unë as që kisha marrë mundimin t'i hekurosja pantallonat, sepse gjithë kohën e kisha harxhuar me flokët që nuk i nënshtroheshin vullnetit tim. Para se të dilja, kisha vendosur t'i qethja, mirëpo, sapo pashë Blertën, i harrova fare flokët.

Tani e ndjeja veten më lehtë, sikur kisha dalë nga një kafaz dhe fluturoja.

Pamë një film të bukur, të cilin nuk e kuptova mirë, jo për faj të regjizorit, por të mendimeve të mia të çuditshme që nuk përqëndroheshin dot në ekran. Gjatë filmit, pa dashje, më shkiti dora dhe preka dorën e saj. Blerta nuk lëvizi. Kur ndjeva ngrohtësinë e dorës, nuk m'u durua dhe e shtrëngova lehtë. Blerta ktheu kokën nga unë dhe pëshpëriti:

— Sokol!

Unë e largova dorën.

Pastaj dolëm. Bulevardi ishte mbushur me njerëz. Heshtëm rrugës, madje edhe kur po ngjitnim shkallët e fakultetit. Ishim vonuar disa minuta, megjithatë pedagogu akoma nuk kishte ardhur. E ndjeja veten tepër të turbullt. Të gjithë më vështronin sikur ndodheshin përpara një ceremonie.

o o o

Përpara se të binim të flinim, në konvikt, njëri nga shokët hipi mbi një krevat, sikur do të mbante një fjalim të zjarrtë dhe tha:

— Një djalosh nga fshati e gjeti dashurinë në kryeqytet.

— Urra! — thirrën shokët, aq sa unë u inatosa.

Por fundja ata ishin shokët e mi, ndaj nuk mbajta mëri për asnjërin.

Edhe atë natë s'më zuri gjumi gjer vonë. Mendoja shumë gjëra. Isha thjesht një fshatar, ndonëse kisha gënjyer se banoja në qytetin S. Po sikur Blerta ta marrë vesh? Ajo do të më përbuzë dhe shokët do të thonë se statuja dështoi në dashuri. Por unë

s'mund të mohoj fshatin tim të bukur, për të cilin kisha shkruar aq vargje. Atë s'do ta braktisja për asnjë vajzë. Që të mbetesh i fshatit dhe shokët të mos qeshnin me mua, unë duhet të hiqja dorë nga trilli i dashurisë. Kështu vendosa një natë vonë, ndërsa shokët flinin dhe përmes xhamavet të dritares hynin në dhomë rrezet e argjenta të hënës. Era fërshëllente lehtë përmes hapësirës dhe mua ndër mend më vinte fshati.

o o o

Shokët e kuptuan se mua s'më kishte ardhur mirë për shakanë. Më kërkuan falje që të nesërmen. Tanushi m'u afrua dhe, pasi më vuri dorën në sup, më tha:

— Ç'ke, Sokol?

— Asgjë.

— Të erdhi keq mbrëmë?

— Pak — i thashë.

— Shokët ashtu e kanë — më tha ai.

Mendoja për veten time dhe për Blertën. Ajo nuk do të pranonte të vinte as për vizitë në fshatin tim të lindjes. Dhe si do t'i thosha unë asaj se e kisha gënjyer për qytetin S.?

Hyra në sallë. Kishim leksion të përbashkët me dy degët e tjera të fakultetit. Salla vërtet është e madhe, por kishin ardhur aq shumë vajza dhe djem, saqë m'u desh të rrija në këmbë.

Vështrova nga fundi i sallës dhe pashë Blertën që bisedonte me një student. U rrëqetha. Ndoshta ky

ishte zhgënjim i vërtetë. E vështrova përsëri. Ajo i buzëqeshte atij. Ishte një djalë i gjatë, me flokë të dredhur. Blerta siç duket më pa, pasi në fytyrë i kaloi një buzëqeshje e çiltër. U ngrit në këmbë dhe më thirri. Kishte ruajtur një vend. Studenti që rrinte më përpara vazhdonte të fliste me Blertën pa e çarë kokën se aty isha edhe unë. Më erdhi inat. Mirëpo e mblodha veten, se nuk ndodhesha në mes të pyllit, por në universitet.

— Je tepër i vrejtur — më tha ajo, pasi mbaroi bisedën me studentin.

— Ashtu?

— Dukesh sikur ke marrë ndonjë lajm të hidhur.

— Mundet — i thashë me inat.

— Çfarë fsheh në shpirt?

— Një të vërtetë që nuk tregohet.

— Kurrë?

Heshta duke shikuar përtej dritares. Pedagogu akoma nuk kishte ardhur dhe studentët bisedonin.

Blerta më vështroi thellë në sy, saqë unë u trondita. Ajo më kuptoi. Zuri të shkruante në letër sa për t'u marrë me diçka sepse dhe ajo diçka ndjente në shpirt. Po çfarë?

Këtë ndoshta nuk do ta merrja kurrë vesh, sepse i tillë jam unë.

Një fshatar që ka mbaruar shkollën pedagogjike me korrespondencë vjen në universitet dhe provon për herë të parë dashurinë.

Ndenja i shqetësuar ca ditë. Për mua jeta e studentit është e panjohur. E megjithatë e di se do të mësohem ndonjë ditë. Atëhere mendimet do t'i shfaq pa drojtje dhe s'do të më vijë keq fare kur shokët do ta mësojnë se vij thellë nga malet. Se malet dhe

fshati im janë aq të bukur dhe unë i dua shumë.

Një pasdite rrija në një lulishte të qytetit të studentëve. Në mbrëmjen e kaluar kishte rënë shi dhe ndoshta për këtë hapësira që krejt transparente dhe dielli dukej më i pastër se ditët e tjera.

Dëgjoja një koncert orkestral. Më pëlqen muzika. Ajo gjithmonë më ngjall në shpirt poezinë. Tingujt e kësaj melodie të bukur më kujtojnë diçka të bukur dhe të largët nga fëmijnia ime.

Përmes xhamave të pallatit shikoja sallën e leximit, ku rrinin shumë studentë. Tej, në fushën e sportit, ca të tjerë loznin futboll. Unë akoma nuk kisha hyrë në botën e tyre, ndonëse kisha ndryshuar ca. Nga pallati hynin e dilnin shumë studentë, të cilët mezi dukeshin për shkak të pjerrësisë së rrugës së asfaltuar. Diku më zuri syri Blertën. Ishte me shoqe dhe mbante në dorë një gazetë. Mendova të ngrihesha dhe të ikja, mirëpo nuk qe sjellje e mirë.

Më pa dhe u shkëput nga shoqet. Tek po vinte drejt meje, tha që larg:

— Sokol!

Vetëm kaq. Ajo sikur do të thoshte edhe diçka tjetër. Vura re se qe skuqur në fytyrë.

— I ke shkruar bukur — më tha.

— Kë?

— Poezitë.

— Mos bëj shaka — i thashë i hutuar.

— Shikoi vetë — më tha Blerta.

Ishte gazeta «Studenti». Për çudinë time të madhe, në faqen e parë qe botuar një cikël poezish për fshatin dhe poshtë emri im.

— S'po të kuptoj — i thashë.

— Ndërsa mua më pëlqejnë — tha ajo. — Sido-

mos ajo që thotë se qielli i fshatit tënd janë gjethet e blerta të pyllit. I ke shkruar kur ishe në fshat, apo tani?

Unë heshta. Blerta e kuptoi heshtjen time. Por nuk e dinte se shokët e dhomës ma kishin punuar. Me siguri ata i kishin marrë poezitë që kisha shkruar e fshehur dhe do t'i kenë dërguar në redaksi për botim.

T'i thosha Blertës për këto? E ç'rëndësi kishte? Ajo tani e mori vesh se unë jam nga fshati dhe jo nga qyteti S.

Përse hesht edhe Blerta? Përse nuk më qërton, veç më vështron me ata sytë e zinj dhe të bukur që s'e kuptoj dot se çfarë shprehin?

MJELLMA E GURORES

Ai nuk hyri në dyqan, por hodhi një shikim të gjatë e kërkues. Kur sytë i zunë shitësen pranë banakut, e mbajti frymën.

Frynte puhiza e mbrëmjes. Qielli mavi mbulohej nga yje që digjeshin.

Herë pas here në hapësirë përhapej gjëmimi i largët që vinte nga gurorja. Ai rrinte si një piketë e ngulur në errësirën e natës.

Fashat e dritës së dyqanit binin mbi trupin e tij që dukej si një statujë e punuar pa shije e ngrontësi, thujse artisti kishte derdhur mbi vepër vetëm anemi trupore. Pas tij shtrihej një sfond i errët, monoton dhe i pakufishëm.

— Vali! — u dëgjua sërish zëri i tij.

Shitësja i tha të hynte brenda, por ai nuk pranoi. Tundi kokën duke preferuar të rrinte jashtë në errësirën që mbulonte guroren, çatitë e pjerrëta të barrakave, oxhakun e lartë dhe të vetmen rrafshinë që formonin malet rreth e rrotull. Zuri të lëvizte në errësirë, pastaj hodhi shikimin në hapësirën mavi të qiellit, që sa vinte e tretej në një ngjyrë të kaltër, përshkuar nga një e verdhë e lehtë floriri. Nga shpatti i malit u ngrit hëna si të ishte një portokall tepër

i madh. Yjet e Arushës së Madhe dhe të Kashtës së Kumtrit, filluan ta humbin shkëlqimin e dridhshëm, aq sa ndonjë u shua fare.

Pas krahëve dëgjoji zhurmën e hapave të saj dhe mori frymë i lehtësuar. Ndezi cigaren. Flaka e shkrepëses ndriçoi fytyrën e vajzës dhe flokët e zez që i derdheshin mbi supe. Ai e admiroi për një çast dhe, kur flaka u shua, iu duk se vajzën ia rrëmbyen duar të padukëshme.

— Vali!

— Ç'ke?

— Asgjë — tha ai. — M'u duk se ike.

Ai mori dorën e vajzës që iu duk e ftohtë.

... Atij nuk i pëlqente që para dyqanit të së fejuarës të rrinin punëtorët e rinj, duke vështruar përmes xhamave siluetën e saj të bukur.

— Thuaju të ikin — i tha së fejuarës.

— Përse? — pyeti ajo.

— Nuk dua që të tjerët të ndiejnë kënaqësi. duke të parë si të babëzitur. Nuk dua.

— Kjo sjellje po më çudit — e qërtoi ajo.

— Më mirë thuaje troç se të pëlqejnë shikimet e tyre. Hë de, folë! Të pëlqejnë?

Vali kishte heshtur.

Ata që rrinin para dyqanit ishin gjashtë punëtorë të rinj. Pasditeve uleshin në stolin ndanë rrugës dhe bënë shakara. Njëri nga djemtë, që punonte minator, kishte trup të drejtë, flokë të verdhë dhe një shikim të mprehtë.

Një ditë i fejuari i Valit u zu me djaloshin bjond, aq sa i nxehur e përplasi në rrugë. Pastaj kishte ikur duke mermëritur fjalë fyese.

Bjondi nuk erdhi më. Shakaxhinjtë mbetën pesë dhe çdo ditë shikimet e tyre shkisin mbi xham për

të parë «mjellmën e gurores». Ai shqetësohej më tepër. E ruante Valin si një margaritar, shkëlqimi i të cilit i përkiste vetëm atij. Një mbrëmje vonë silueta e tij përshkoi rrugën nga gurorja për te dyqani i së fejuarës. Kishte rënë mjegull dhe barrakat mezi dukeshin. Përmes hapësirës së lagur dëgjoheshin lehjet e mbytura të qenve, që vinin nga fshati përkundrejt. Vështroi rreth e rrotull, gjersa gjeti stolin që e urrente aq shumë, aq sa kishte dëshirë ta shkulte dhe ta përplaste tutje në shkëmbinj e të bëhej copë e thërrime. Provoi ta ngrinte, por nuk mundi; këmbët e stolit qenë prej hekuri dhe të ngulura thellë në tokë.

Dëgjoi një kollitje. U mblodh kruspull pas stolit dhe, kur hapi i rojës plak humbi tutje, nisi nga puna. Si mbaroi, hodhi kovën dhe u zhduk përmes mjegullës.

Të nesërmen njëri nga pesë shokët e bëri tërë graso kostumin e ri që sapo kishte blerë. Katër të tjerë rrethuan stolin para dyqanit duke thirrur me zë të lartë e duke thënë se mbrëmjeve me mjegull dikush dilte për të lyer stolat me graso. Pastaj djemtë hodhën nga një vështrim të zemëruar nga dyqani dhe s'u panë më. Vali u skuq. Ndjeu diçka të ftohtë që kishte depërtuar në shpirtin e saj. I tha të fejuarit. Ai tundi kokën.

— Nuk do të vij në më.

— Kush? — e pyeti ajo.

— Ata shakaxhinjtë e tu nuk do të vij në më.

Vali kishte heshtur. Në sytë e saj i fejuari sa vinte e zvogëlohej. Ai donte ta largonte nga njerëzit, ta linte të vetmuar. Ajo vështronte çdo ditë përmes transparencës së xhamave. Shpesh i dukej se dë-

gjonte zëra të gëzuar, por, kur kthente kokën nga rruga, shihte vetëm stolin e përgjumur.

Në rrugë u duk një minator i vjetër me fytyrë të gjerë eshtërore, tërë njolla të zeza sikur të kishte djegur barut në lëkurë. Plaku vështroi dyqanin, përshëndeti vajzën me dorën e djathtë dhe u ndal para stolit. Nxori sqeparin nga brezi dhe zuri t'u binte dërrasave me nervozizëm. Pastaj vuri sqeparin në brez dhe u nis drejt gurores me hap të rëndë e të vendosur sikur të kishte kryer ndonjë akt heroik.

Vali doli në rrugë, desh të qërtonte plakun, por ai ishte zhdukur. Në anë të rrugës kishin mbetur vetëm dy hekura të ngulur në tokë. Copa dërrasash dhe gurë. Mori një dërrasë. Ishte e kalbur vende-vende.

«Bëri mirë plakun, tha me vete. Bëri mirë!»

Të nesërmen i thanë se i fejuari ishte zënë keq me punëtorët e gurores dhe minatori plak, që nuk dinte si të shprehte urrejtjen ndaj xhelozisë së tij, kishte prishur stolin.

Pastaj filluan shirat. Ajo rrinte në banak e mër-zitur me shikime të ngulura në hapësirën e mbuluar me pika shiu që binin duke shtuar pellgjet e rrugës.

... Ata ecnin në errësi.

— Vali!

— Hë.

— Përse je kaq e ftohtë?

— Ku ta di? — tha ajo. — Ndoshta pse zemërimi i plakut e theu stolin me një të goditur.

U dëgjua zhurma e një maqine që vinte kundrejt tyre duke ndriçuar. Ai u fsheh në errësi.

— Eja tha duke e tërhequr vajzën nga dora.

— Ku?

— Diku larg, Vali. Larg.

Ajo u drodh. Maqina kaloi pranë tyre me vrull duke shpërndarë copëra balte.

— Më mirë të shkojmë në gurore te shokët — tha ajo. — Këtu të mbyt errësira.

— Vali! — thirri ai i zemëruar.

— Ç'ke?

— Ëkim në L. Do të gjejmë një shtëpi të bukur.

— Ti nuk di ç'flet — i tha ajo.

— Vali!

— Eja te shokët — tha vajza duke ecur me hap të nxituar.

Ai u inatos.

— Kurrë.

Vrapoi pas së fejuarës që mezi dallohej, por diku shkau. Ishte një pellg. Ftohtë. Hëna shfaqti pasqyrimin e plotë të bukurisë së saj mbi sipërfaqen e ujit, por lloçitjet e tij plot dëshpërim e prishën pasqyrimin e saj të përkryer. Vajza diku u ndal. Mbajti frymën pezull, duke vështuar, por ai nuk dukej. As çapi i tij nuk dëgjohej. Ajo mori frymë e lehtësuar dhe u nis drejt dritave të gurores nga vinin zëra të ngrohtë e njerëzore.

NDANË QYTETIT

Ai ishte një plak i mirë. Kishte sy të gjallë dhe të bukur. Duart i kish të arta dhe zemrën të madhe. I donte shumë njerëzit dhe u gatuante bukë të ngrohta. Por erdhën kohë të vështira. Luftë. Njerëzit kishin uri, por furrtari plak nuk kishte ç'të bënte. Njerëzit kishin pak miell. Ai nuk kishte ç't'u gatuante, veç zemrës së tij.

Kur hynë italianët në fillim të prillit, atij iu thye zemra dhe një brengë e madhe zuri vend në shpirtin e mirë. Iu kujtua lufta e dymbëdhjetës dhe psherëtiu. «Eh, kohë, kohë! Mbreti, që premtoi se do të vishte opingat, ua mbathi këmbëve për në Greqi. Tradhëtoi, he, lëntë kockat udhëve, i lëntë!»

Ai rrinte duke pyetur veten se si do t'i vinte filli i kësaj pune, kur një ditë ia behën tre njerëz të armatosur dhe i kërkuan ndihmë. Djemtë e malit! Me se do t'i ndihmonte? Ata luftonin pa bukë e me pak fishekë. Rrobet i kishin të grisura dhe dimri bënte i egër.

Plakut i regëtiu zemra nga një ndjenjë e thellë gëzimi dhe që nga ajo ditë bukët e ngrohta ngjiteshin në mal duke avulluar ngrohtësinë dhe dashurinë e furrtarit plak.

Ai qe tronditur kur porta trokiti dhe brenda hyri një partizan i plagosur. Shokët e sollën partizanin te furra ndanë qytetit dhe ikën duke ia lënë amanet plakut, i cili, si ia lau plagën dhe e lidhi mirë, e vuri në një qoshk të ngrohtë. Pastaj solli qumësht dhe, ndërsa partizani pinte, plaku e vështronte me dashuri.

— Kush të qëlloi, biro?

— Ai. Tenentja i kuesturës.

— Pastaj?

— E vrava qenin.

— Si?

— Ashtu. I dola përballë. I thashë se populli për krimet e tij e kishte dënuar me vdekje. Por ai qe i shpejtë. Nxori pistoletën dhe e shkrepiti. Më zuri pak, mbi sup. Ja këtu. Plumbat e revoles sime ia zbraza mu në gojë. U shtri në mes të sheshit, sa gjerë gjatë dhe nga koka i rridhte gjaku i ndyrë. Kishte marrë në qafë sa djem qeni!..

Plaku e shikonte partizanin me dashuri. S'duhej të qe më tepër se njëzet e pesë vjeç. «Sikur im bir të ishte gjallë, sikur të mos i kishte lënë kockat diku në mërgim, tani do të endej maleve me partizanët». Plaku mendoi gjatë. Pastaj u kujdes për partizanin sikur të ishte djali i tij.

Kur erdhën shokët ta merrnin, plaku zgjati një revole me dorezë të bardhë dhe tha:

— Merre, Martin! Është e tim biri që vdiq diku larg. Dhe ejani më shpesh, bijtë e mi. Më shpesh...

Furrtari dhe partizani u përqaftuan. Kaluan mjaft kohë.

Pastaj erdhën gjermanët.

Furrtari kërkoi të dilte në mal me batalionin

partizan. I thanë se do t'ia plotësonin dëshirën. Por jo tani. Më vonë.

Ai heshti. Mirëpo kaluan ditë dhe asnjë nga partizanët nuk po vinte. Dëgjoji se diku tej gjermanët kishin rënë në pritë dhe qenë dërmuar keq. Flitej gjithashtu se partizanët do të sulmonin qytetin, ndaj periferive u vendosën ushtarë pushtues. Përpara furrës u ndalua një motoçikletë.

— Ej, plak — i thirri oficeri gjerman. — Partizanë vijnë qytet. Ushtari mbron. Partizani kaput.

— S'ka partizanë — tha furrtari. — Janë në mal — dhe tregoi me dorë lart.

Oficeri seç foli gjermanisht duke u kërcënuar dhe u nis.

Ushtari gjerman hyri brenda dhe vendosi mitralozin e lehtë tek dritarja e prapme e furrës. Motoçikleta ngriti pluhur rrugës dhe pas pak u zhduk midis shtëpive të përgjumura të qytetit. Furra ishte në periferi.

Ushtari shëtiste sa andej-këtej dhe po e mërziste shumë furrtarin, aq shumë sa furrtari ishte gati t'i hidhej në grykë e ta mbyste me duart gjithë brumë. Kur i erdhi ndihmësi, pak punë kishte mbetur. I dha fund brumit, ndezi furrën dhe ndihmësin e la të lirë. E porositi, djaloshin që t'i thoshte ca fjalë këpucarit. Ai do ta kuptonte parullën menjëherë: «Erdhën.»

— Ku shkon? — pyeti ushtari me zë të vrazhdë.

— Në qytet. Ushqime — tha djaloshi.

— Më blini cigare.

Plaku tundi kokën. Ndhimësi u nis. Ushtari merrte një melodi të vendit të tij, ndërsa plaku mendonte për bukën që do të dilte e bardhë e që njerëzit e dëshëronin shumë. Luftë. Uri.

Era që frynte nga dritarja e hapur ia freskonte trupin e lodhur. Për një çast iu bë se ra një qetësi e thellë. Ushtari nuk lëvizte, por shikonte nga dritarja e prapme. Dëgjohej vetëm zhurma e drurve që digjeshin në furrë. Pastaj ushtari nxori pistoletën nga këllëfi. Furritari vështroi nga dritarja. Diku larg, dukej një njeri që i afrohej furrës. Silueta e tij sa vinte e zmadhohej.

— Ndal! — thirri ushtari duke drejtuar pistoletën.

Furritari u drodh. Njeriu, me të dëgjuar zërin, mori nga e djathta ku ndodhej një pemë e madhe. Ushtari qëlloi dhe njeriu ra barkas, duke u fshehur pas drurit. Furritari plak u zbeh. E kuptoi se njeriu që vinte nëpër atë shteg ishte korrieri i partizanëve dhe ushtari mund ta vriste nga çasti në çast. Apo e kishte vrarë? E si mund ta shikonte vrasjen e një partizani me gjakftohtësi? Jo. Ishte e pamundur.

Rrëmbeu me shpejtësi një dru dhe iu hodh ushtarit armik. Pushtuesi ishte i ri, i fortë dhe kishte vrarë shumë bij të kësaj toke. Do ta kishte vrarë edhe furrтарin plak, sikur ky të mos e qëllonte pas koke aq fort, sa që sytë iu perënduan në çast. Ushtari u përplas në tokë me kokën të shtrënguar midis duarve.

«Të iki tani», mendoi plaku, duke nxjerrë automatikun nga arka e brumit. Doli nga furra. Prapa drurëve vuri re njeriun që ishte shtrirë përtokë. Iu kujtua mitralozi. E rrëmbeu me shpejtësi nga dritarja, ku e kishte vendosur ushtari, dhe e hodhi në krahë. I thirri njeriut të rrëzuar pas drurëve dhe pa se ai i kishte drejtuar pistoletën.

— Jam furritari — tha.

E arriti. Fytyra e partizanit ishte e njomë dhe e

panjohur. Ishte plagosur në krahun e majtë. Furrтари nisi t'i lidhte plagën.

— Vetëm je?

— Dy — foli partizani duke treguar fshatin e afërt.

— Martini?

— Jo, Lumja. Është plagosur rëndë dhe deshëm ta sillnim në qytet.

— E ndjen plagën? — pyeti furrтари duke i prekur krahun.

— Pak. E ke lidhur më mirë se mjeku ynë.

Plakut i rrahu zemra fort.

— Martini pse nuk erdhi?

— ... E vranë — tha partizani duke e vështuar në sy.

Sytë e bukur të plakut u drodhën dhe diçka e ngrohtë rrodhi prej tyre. Ç'qenë ato? Pika gjaku? Dhe rrodhën lehtë nëpër lëkurën e reshkur të fytyrës së tij. Diku u shkrinë, humbën dhe ai u drodh përsëri. Partizani s'ia ndante sytë.

— Luftë, xhaxha. Ishte korrieri më i mirë i batalionit.

E tradhëtuan ballistët e një fshati. Vrau tre prej tyre.

— Martini?

— Po.

Ata ecnin me shpejtësi përmes drurëve dhe gjetheve të verdha që binin e binin pa pushim.

— E kishe të afërt?

— Shok.

— Ishte trim — tha partizani.

— Ka vranë ballistë, the?

— Po, xhaxho.

— Tre për Martinin qenë pak. Tani u bënë katër.

Partizani pohoi me kokë.

Morën një të përpjetë. Plaku herë pas here kthente kokën. Diku u ndal. Diçka ndjeu. I tha partizanit të ndalonte dhe mbajti vesh. Larg në rrugën e qytetit dukeshin tri njolla të errëta që sa vinin e zmadhoheshin.

Furrtari pa andej. Pushtuesit zbritën nga motorcikletat dhe, para se të hynin në furrë, lëshuan disa breshëri automatiku.

— Lumja duhet shpëtuar — tha furrtari duke përgjuar lëvizjet e gjermanëve.

— Luftoj unë — tha partizani duke drejtuar automatikun.

— Jo, biro. Është radha ime.

— Bashkë, xhaxha.

— Jo.

— Përse?

— Jo! — tha përsëri plaku dhe shtoi: — Duhet të më bindesh.

Partizani i ri heshti. Lumja duhej shpëtuar. Që ta shpëtonin, gjermanët duheshin gozhduar në vend. Ndryshe do t'i ndiqnin nga prapa.

— Natën hyre në fshat?

— Natën.

— Të pa njeri.

— Përse pyet?

— Ai fshat ka ballistë — tha plaku.

Partizani u zbeh në fytyrë dhe vështroi fshatin që dukej larg mbi një kodër, midis pemëve të zverdhura.

— Dikush duhet t'i mbajë armiqtë.

— Po.

— Atëhere ik. Ç'pret? Shpëto Lumen.

Plakut diç iu kujtua.

— Ke fishekë?

— Kam.

— Silli këtu.

Nxori karikatorët nga çanta dhe i vuri rrëzë një peme të madhe.

— Mitralozin t'ia japësh komisarit. Dëgjove? Komisarit në dorë. Dhe t'i thuash se për Martinin tonë tre qenë pak, Hajde të të puth.

Sytë i vezullonin. Lotët e trdhëtuan plakun.

Malli për Lumen e gjithë partizanët. Partizani i ri diç ndjeu. U trondit. E puthi plakun fort.

— Të shpëtosh, xhaxha! Të shpëtosh!

Trupi i partizanit me mitraloz humbi pas dru-rëve.

Dielli perëndoi dhe hapësira u bë e kaltër. Push-tuesit afroheshin. Priti. Qenë mjaft për Martinën. Mjaft. Rrudhat e ballit iu thelluan. E ç'nuk mendoi ato çaste. Kur qëlloi me automatikun që i kishin fal-lur partizanët nëpër ajrin e lagur të buzëmbremjes, u shpërndanë klithmat rrënqethëse të një gjuhe të huaj që s'donin ta njihnin as njerëzit, as malet.

Pesë. Gjashtë. Edhe një... Tetë... Nëntë.

Ra përmbys mbi gëzhojat e ngrohta dhe ngriti kokën paksa. Në hapësirën e kaltër përhapeshin shtëllungat e zeza të tymit që nxirrte furra. Vjeshtë. Gjethe dhe drurë.

BRIGADIERI I VJETËR

Njëzet e pesë vjet kishte xha Ademi në stabilimentin e sharrave. Nuk janë pak njëzet e pes vjet. Të vish djalë i fuqishëm dhe të bëhesh burrë i mosshuar me pak fuqi, por me më shumë mend. Zbriti nga mali me një dyfek dhe me një trastë plaçkash ku qe fshehur një abetare e grisur. Kishte mbaruar lufta dhe dyfeku i Ademit, që nxirrte akoma tym, u var në një gozhdë në stabilimentin e sharrave.

Mësoi gjëra të reja. U bë gatrishi më i mirë dhe punëtorët e tjerë, e thërrisnin «mjeshtër». «Mjeshtër», i mbeti emri.

U ndërruan drejtorë e përgjegjës, por mjeshtri Adem mbeti aty pranë gatrishit, i gjatë dhe i drejtë si qiparis. Por jeta rridhka shpejt, kaq shpejt, sa që një ditë mjeshtri u plak. E larguan nga gatrishi. Nuk i erdhi mirë, por ç'të bënte? Erdhën ca të rinj të fuqishëm dhe mjeshtrit i vajti mendja te rinia e tij e largët.

E caktuan brigadier fushe në repartin e stivimit të dërrasave. Punën e filloi pa qejf. Një e dy dhe vërtitej nga gatrishi ku punonte ca. Sa për t'u çmallur, se i shkreti zanat nuk harrohet lehtë. Brigadier u bë, por emri mjeshtër i mbeti.

I pëlqente më tepër emri mjeshtrë. Çështje zanati. «Pa të drejtosh, mendonte lehtë është». Ca urdhëra andej, ca këtej dhe punët me repartin e stivimit venin për bukuri.

Një ditë i sollën një punëtor të ri. Ishte maturant dhe mjeshtri e quajti shkollar. I riu nuk ia mbushi syrin. Një pëllëmbë njeri qe. Ç'do ta bënte këtë pëllëmbë trup në mes të dërrasave e të trupave të stabilimentit?

— Ujë të na sjellësh — i tha mjeshtri Adem punëtorit të ri. — Ujë, pa të tjerat i bëjmë ne.

I riu nuk bëri zë.

Brigada merrej me stivimin e dërrasave në sheqin e madh para stabilimentit. Bënte vapë. Punëtorët kishin hequr kanatjeret dhe dielli ua kishte nxirë lëkurën.

Mjeshtri Adem e kishte ndarë brigadën në grupe të vogla ku secili zgjidhte shokun e punës dhe ndahej mënjandë.

Kishte mënyrën e vet të të drejtuarit që punëtorët e quanin «stili i mjeshtrit Adem». Për të riun askush nuk tha gjë. E kush do ta merrte në grup?

E sollën dy javë me gjym të ujit. Shkonte dhe vinte, por askujt nuk ia zinte udhën.

— Lehtë e ke — i thoshin. — Një gjym ujë asgjë nuk është. Duket se e ke mirë me mjeshtrin, qerrata.

Një ditë punëtorit të ri nuk iu durua. Erdhi në mëngjez më herët se punëtorët dhe nisi të stivonte. E kishte vështirë. Dërrasat e pishës ishin goxha të rënda, por lëshonin një erë të këndshme që kishte dëshirë ta ndijonte.

Erdhën punëtorët. Erdhi edhe mjeshtri. Por nuk i thanë gjë dhe vazhdoi të punonte në një cep të fushës. Kishte hequr edhe kanatjeren. Trupi i tij ishte

i bardhë dhe i dobët. U djersit shpejt. Kur u lodh mirë, vendosi të pushonte te tenda që kishin ngritur me dërrasa pishe.

— Shkollar, o shkollar! — e thirrën punëtorët.
— Na sill ujin!

Punëtori i ri as që ua vuri veshin, por u ngrit dhe vazhdoi punën. Pas pak zunë të thërrisnin përsëri. I erdhi plasje. Vendosi të mos ua kthente fare, mirëpo diku larg u duk mjeshtri. Bëri, ç'bëri, e mori gjymin. Kur brigadieri erdhi pranë tij i tha:

— Kisha diçka, mjeshtër.

— Folë, shkollar.

— Pse nuk e sjellin me tub ujin?

Mjeshtri qeshi dhe i rrahu krahët.

— Do t'i shpëtosh gjymit, hë?

— Jo për atë. Them për sigurimin kundër zjarrit.

Mjeshtri tundi kokën. Nuk e kishte keq shkollari. Megjithatë iu duk se punëtori i ri donte t'i shpëtonte gjymit.

«Epo, punë më të lehtë nuk ka ku gjen,» mendoi mjeshtri, pastaj i tha punëtorit:

— Do të shohim.

Pas një jave filluan punimet për hapjen e kanaleve. Do të merrnin ujë te një fabrikë e re që po ngrihej aty afër. Ama gjymi i mbeti që i mbeti shkollarit. I premtuan që, sapo të vendoseshin tubat, do ta caktonin në një punë tjetër. Ai pranoi. Mirëpo punimet po zgjatnin shumë, se mungonin tubat. Ato të degës së shpërndarjes kërkonin ndërmarrje më ndërmarrje dhe nuk po gjenin. Shkollarit nuk i durohej. I dukej se e fyenin goxha djalë të mbartte ujë me gjym, kur këtë punë mund ta bënte një pensionist për mrekulli.

Sa herë i kalonte pranë, mjeshtri Adem i thoshte:

- Ej, shkollar, ke shpikur gjë tjetër?
- Jo, mjeshtër. Po si shumë po e zvarrisin.
- Mall importi, mor bir. Po ti mos u mërzit.

Hëpërhë mirë je.

Nuk ia merrte për të keq brigadierit që ishte burrë i moshuar dhe babaxhan.

Një ditë, kur brigadieri e pyeti si zakonisht, i tha:

— Kam edhe diçka.

— Pa hë, ç'të polli mendja kësaj radhe?

— Për ndarjen e punës. Kolektive do të qe më mirë.

— Kolektive, the?

— Po, mjeshtër.

— U bëre të na japësh mend, more bir.

— Ta marrim shtruar, mjeshtër. Ka të mira proçesi zinxhir. Do të shtrohen dërrasat mirë e bukur. Kështu si stivohet tani, nuk bën. Stivat nuk janë të rregullta. Secili për hesap të vet dhe, o burra, të ikim. Kjo nuk është punë e mirë.

— Si nuk qenka punë e mirë? — u nxeh brigadieri. — Ti dje erdhe dhe dashke të vendosësh rregulla të reja. Sikur ne nuk dimë ç'është e mira.

— Po unë. . .

— Lëre, lëre, o shkollar. Puno aty ku të caktojnë, pa për të drejtuar është caktuar një njeri.

— Kuptomë — i tha punëtori i ri. — Për të mirën e punës e kam. Edhe norma më shpejt do të bëhet.

Por brigadieri Adem iku dhe nuk dëgjoji më se ç'tha punëtori. I erdhi inat. Një punëtor i ri e kritikonte, se nuk drejtonte mirë. Epo si drejtohet ndryshe? Mos vallë duhet dëgjuar një kalama, që vetëm dy muaj ka që punon në stivim. Jo, ore, jo. As që do

t'ia vinte veshin. Apo mos e bën që, kur të vijë uji, të hajë në kurriz të shokëve? Në do të punojë, të rrijë. Të ulë kokën dhe të mos futë hundët kudo. Për zjarrfikësit mirë bëri që foli. Ama kësaj radhe e shkeli. Hajde, baba, të të tregoj arat. Veza! Unë kam njëzet e pesë vjet në stabiliment dhe më mirë se tani kurrë nuk është punuar. Njëzet e pesë vjet. S'mbahet mend që kur.

Kaluan ditë. Punëtori i ri e fshehu gjymin midis dërrasave të pishës dhe nuk u solli ujë punëtorëve. Nuk ishte larg çesma. Dý hapa. Por u mësuan punëtorët me shkollarin, ndaj kërkuan gjym të ri. Brigadieri u solli një tjetër. Shkollari përsëri e fshehu gjymin dhe kundër tij filluan të flisnin të gjithë. I thanë dembel, por ai nuk e prishi gjakun.

— Epo mirë — i tha brigadieri. — Do t'i paguash me rrogën.

— Mirë, brigadier.

— Dhe do të punosh me normë si shokët.

I caktuan një vend të vështirë shkollarit të pabindur dhe dembel. Dy ditët e para nuk bëri as çerekun e normës. Punëtorët e shikonin nga larg dhe nënqeshnin. Njëri i tha:

— I re së mirës me shkelm, o shkollor. Ti kurrë nuk do ta bësh normën.

Ai nuk e bëri veten.

Një ditë ndenji gjer në orët e vona dhe, kur erdhi të nesërmen brigadieri me metër, u çudit. Një normë plot.

Mjeshtri Adem mendoi se mos i kishte ndihmuar ndonjë shok dhe tundi kokën lehtë, sikur t'i thoshte shkollarit se ato çapkenllëqe i kishte bërë edhe vetë dikur. Por metri i brigadierit u tregua përsëri kokë-

ngjeshur. Ditën tjetër përsëri mati. Një normë. Mjeshtri filloi të shikonte me habi trupin e vogël të shkollarit që qe nxirë tashmë.

Punëtorët iu afruan. Dikujt i erdhi keq që lodhej aq shumë dhe i kërkuan brigadierit ta fuste në ndonjë skuadër. Shkollari nuk pranoi.

— Kolektiv, po deshët. Është më mirë.

— Prapë me tënden?

— Po, mjeshtër.

Mirëpo, edhe brigadieri kishte filluar të ndryshonte ca. Nuk ish dembel shkollari. Mendoj keq në fillim brigadieri. I dukej se shkollari kërkonte kolektiv që të hante në kurriz të shokëve. Por s' ishte i tillë. «Vërtet lodhët, por normën e bën për bukuri. Punëtor, s'ke ç'i thua.»

Një ditë brigadieri i shkoi pranë dhe zuri ta ndihmonte. I vinte keq kur e shihte të mbytur në djersë. Punëtorit të ri i erdhi mirë. E pra ata nuk i folën njëri-tjetrit. Kur u lodhën, u ulën në tendën me dërrasa pishë.

Mjeshtri Adem nxori paqetën «Ardian» dhe ia zgjati.

— Merre, shkollar.

— Nuk kam ndër mend ta pi, brigadier.

Në shpirtin e mjeshtrit Adem diçka zhvillohej. Ndaj herë pas here edhe ky e shikonte punëtorin drejt në sytë e zinj, ku i dukej se lexonte diçka, diçka të çuditshme, por të ngrohtë. Turbull, turbull, po më në fund kishte mësuar t'i lexonte gjërat në sy. Dhe ra në mendime.

Iu kujtua se tashmë ishte plakur dhe shumë gjëra nuk i kuptonte siç duhej. Megjithatë nuk i erdhi keq. Pastaj brigadieri e zuri llafin larg e larg dhe më së fundi ia tha troç.

— Nesër e kemi kolektiv.

FEMIJNI E ÇUDITSHME

Ne bridhnim rrugëve të shtrembëra me një shkop druri në mes të këmbëve dhe më dukej vetja si kalorësit më të famshëm të botës. Kuptohet, bota jonë ishte fëmijnore, fillonte te dyqani i bakallit sydhel për dhe mbaronte te një shesh ku bëhej pazari të dielave. Ne ëndërronim për një kalë të bardhë dhe, sa herë shihnim ndonjë andej nga kovaçhëna, ku vinin fshatarët, vraponim si të çmendur. Ne i donim kuajt, dhe na pëlqente t'i kundronim, duke i përkëdhelur me dorë, por kovaçi me sy të kuq dhe krahëlakuriq na vështronte egër dhe dëshira jonë fashitej. Kovaçit ia kishin frikën të gjithë. Ai fliste pak dhe, kur hapte gojën, ngjirej.

Bakallin e kishim inat, se ishte njeri i lig, qeshte me djallëzi dhe ne do t'ia kishim thyer xhamet sikur t'u vinte kapakë dritareve. Në rrugicën tonë shkolinin e vinin shumë matrapazë. Ndër të gjithë, vetëm njërin e kishim me sy të mirë. Ai ishte një fotografist plak me një aparat që kishte tri këmbë druri dhe që ne e quanim «lejlek». Fotografi vinte çdo mëngjez dhe, pasi vendoste copën e kuqe në faqen e murit, i thoshte ndonjërit prej nesh të mbushte kovën me ujë. Ne i bindeshim atij. Fotografi kishte

qenë përtej detit shumë vjet dhe ishte kthyer me aparatën e tij të çuditshëm me tri këmbë druri të gjata, që mblihdeshin.

Ai na tregonte herë pas here për botën matanë detit. Thosh se, po të shihje pallatet e bardha që e kishin çatinë në qiell, të verboheshin sytë. Përmen-dte herë pas here emrin Evropë dhe ne, që nuk ki-shim hyrë në shkollë akoma, ngrinin supet. Plaku qeshte duke treguar gjithë hapësirën:

— Është shumë e madhe Evropa!

Atëhere ajo hapësirë e madhe me emër të rrallë mbulonte gjithë qenien tonë. Ne hidhëroheshim. Pra, paska një vend andej përtej detit që ishte më i bukur se rrugica jonë. Kjo s'na pëlqente fare. Ne na dhim-bsej kjo rrugicë e shtrembër që fotografi e quante gjënë më të shëmtuar në botë. Ne ngrinin supet dhe përfytyronim një vend të bukur pranë detit.

Kudo nëpër këtë qytet fantastik rendin kuaj të bardhë me jete të gjatë dhe thellë në shpirt na fliste një zë që thoshte të zgjidhnim ndonjërin, mirëpo në çatin e pallatit më të lartë dilte fytyra e kovaçit sy-kuq.

Ne i kishim frikë ata sy.

Por ndodhi një gjë e çuditshme, që i preu ëndë-rat tona në mes. I pamë nënat tona t'i qaheshin njëra-tjetrës dhe të shkullnin leshrat e veta me kuje. Ne nuk e kuptonim ç'po ndodhte.

Baballarët delnin herët dhe vinin vonë. Ata rrinin të heshtur dhe kokën e mbanin ulur, sikur kërkonin diçka. Shikonim pluhurin e rrugicës sonë të shtrem-bër. Ne nuk guxonim t'i pyesnim. Ata tregoheshin të ashpër, sikur fajin për atë që po ndodhte e kishim ne kalamajtë, që bridhnim rrugëve dhe i binim pëllëmbë

për pëllëmbë botës së pluhurit që nuk ishte e shëmtuar, siç thoshte fotografi plak.

Ne i harruam qytetet fantastike dhe kuajt.

Harruam kur mbaronte një ditë dhe fillonte një tjetër, sepse çdo gjë dhe vetë qenia jonë që lidhur me atë që po ngjiste.

Një mëngjez dëgjuam zhurma të largëta që sa vinin e shtoheshin. Dolëm nga dyert fantastike të ëndrrave dhe pamë një pluhur që ngrihej lart.

Ne ëndërronim kuaj të bardhë që zbrisnin nga malet e kaltëra të vendit tonë, por u zhgënjem. Në rrugicë ecnin ngadalë ushtarë me kaska prej çeliku që bënin zhurmë të madhe dhe e ngrinin pluhurin duman.

Nënat na tërhoqën brenda dhe na shtrënguan në krahët e ngrohtë.

Më zuri frika. Nuk bridhnin më netve me hënë kopshteve siç bënim dikur. Nënat na mblidhnin herët dhe i kyçnin mirë dyert, sikur natën do të vinin hajdutët që të vidhnin sëpatën e babait, me të cilën gjithë ditën çante dru nëpër dyert e botës, ndërsa në mbrëmje e linte në një qoshe të shtëpisë.

Vetëm bakallit i qeshi fytyra e tij e ndyrë, si e dhelprës.

Mbylli dyqanin dhe pas ca ditëve dëgjuan të flitej se do të hapte një mejhane të madhe mu në krye të rrugicës sonë. Ne nuk na pëlqeu kjo. As fotografit plak nuk i pëlqeu. Na tha se bakalli i ngjante një qeni që lëpinte çizmet e atyre që kishte nxjerrë deti.

— Nga Evropa — i thamë ne.

— Evropa — përsëriti ai.

— Po pallatet e bardha që shkëlqejnë? — e pyetëm.

Ne nuk i harronim kurrë tregimet e tij për qytetet e mëdha.

— S'i paskeni harruar ende?

— Jo.

— Në ato pallate jetojnë njerëz të ndyrë.

Neve na erdhi mirë. Rrugica jonë nuk ishte as e shëmtuar dhe as e shtrembër si plakë çalamane. Ai kot kishte thënë dikur. Me siguri qe penduar. Sytë e tij të bukur shprehnin dashuri dhe dhembje, ndaj na erdhi keq për fotografimin. Arësyen nuk e dinim.

— Ejani — tha, duke na rreshtur fare pranë copës së kuqe që nuk na merrte të gjithëve. Fotografi na ndau nga një. Pastaj shkrepim «lejlekun» me këmbë druri, duke e vënë syrin te një vrimë e vogël. Ne i kishim mësuar të gjitha lëvizjet e tij. Na kishte premtuar se të gjithëve do të na mësonte atë zanat që na dukej i mistershëm.

I sollëm një kovë ujë dhe brenda në masën e ftohtë dhe transparente pamë të binin ca letra të bardha ku qemë vizatuar ne. Më vonë fotografi na ndau nga një fotografi të vogël dhe ne vrapuam drejt e në shtëpi. Nuk dinim ku t'i vinim. Cila qoshe e shtëpisë sonë qe më e bukur dhe e meritonte këtë nder të madh? Të nesërmen shkuam me ca para në duar te fotografi, i cili na tha t'i çonim në shtëpi që të blinim bukë për nënat e baballarët. Ashtu bëmë. Atë natë im atë, për herë të parë pas aq kohësh, qeshi dhe tha se fotografi plak ishte njeri i mirë, por fatkeq. Kishte mbetur fillikat në jetë.

— Ka «lejlekun» — thashë unë.

Babai përsëri qeshi. Asaj nate pamë ëndrra të bukura. Ne kishim një mik të mirë, me të cilin takoheshim çdo mëngjez te qoshja e rrugës së shtrembër.

Fotografi na tha një ditë se do të vendoste «lejlekun» në fund të rrugicës ku fillonte pazari dhe ne e shpërngulëm bazën tonë. Në pazar kishte gjallëri, dhe herë pas here dukeshin ata që kishin ardhur nga deti. Ca erdhën te «lejleku» dhe dolën në fotografi. Plaku e dinte mirë gjuhën e tyre dhe merrej vesh. Ne vetëm dëgjonim, pa kuptuar asgjë. Pastaj ata të përtejdetit që rrinin si të ngrirë para copës së kuqe, ushtuan.

Një ditë na tha:

— Më ka thirrur kuestori.

— Përse?

— Do të ma tregojë ai vetë.

Ne na hyri frika dhe të nesërmen ndenjëm gjithë ankth për mikun tonë. Po ai erdhi. Hoqi kapelën dhe na e hodhi neve.

— Merreni.

— Ç'na duhet?

— Lozni me të.

— Po ti?

— Do të vë një qeleshe — tha duke nxjerrë ca para nga xhepi.

I tha njërit të shkonte te dyqani i Sulos për të bërë një porosi. Ditët e tjera ai doli me qeleshe të bardhë dhe të gjithë u çuditën, madje edhe baballarët menduan për këtë gjë që ndodhi papritur në rrugicën tonë të vogël. Ne e morëm vesh të vërtetën. Kuestori kishte dashur ta fuste nëpunës në kuesturë, por ai nuk kishte pranuar. I kishin thënë edhe për përkthyes, por kot.

— Po ç'të duhet qelesha? — e pyetëm.

— Kjo është e bardhë — na tha.

Nuk e kuptuam dhe, ta pyesnim më tej, na vinte turp.

Dinim se ata të përtejdetit vishnin këmisha të zeza, ndërsa malësorët mbanin qeleshe. Im atë më tha se shqiptari gjithmonë ka qenë i drejtë si lis dhe kryelartë si shqiponjë. Kaluan mjaft kohë. Bakalli e ndërtoi mejhanen. Atje vinin fashistë. Ai kishte mbetur i ndyrë siç kishte qenë, ndonëse rrobet e tij nuk i kishte askush. Rrinte si i ngrirë. Ne, sa herë e shihnim, e përfytyronim duke lëpirë çizme.

Miku ynë fotograf nuk na foli më për vendet përtejdetit. As ne nuk e pyesim. Na tregonte për kreshnikët që jetonin maleve dhe që ishin të fuqishëm sa të thërmonin një shkëmb.

Kur vinin fashistët, ne ngriheshim si të zënë në faj, por miku ynë na mësoi të shikonim me urrejtje. Ne nuk duhej të kishim frikë nga askush.

Një ditë ata të përtejdetit e rrethuan pazarin. U bë rrëmujë e madhe dhe fshatarët e trembur iknin me vrap. Kishin frikë se mos i vidhnin. Ne qëndruam si të ngrirë afër fotografit duke e shikuar në sy, sikur t'i thoshim se nuk kishim frikë. Ai buzëqeshi. Pastaj nxori nga xhepi një leckë të mbështjellë dhe tha:

— Kush është më guximtari?

Unë vura dorën mbi gjënë e mbështjellë. Shokët më vështruan me cmirë. Secili nga ne donte të merrte sendin e mbështjellë dhe t'i tregonte mikut tonë se qemë besnikë. Ai e kuptoi këtë.

— Po ju jeni të gjithë trima të vegjël. Ik edhe ti, Vehbi. Ja jepni kovaçit në dorë dhe i thoni të ikë. Shkoni tani. Ç'më shikoni ashtu? Të tjerët në shtëpi. Shpejt!

Nuk donim të ndaheshim nga miku ynë, por ne i bindeshim atij. Vrapuam përmes njerëzve dhe hymë te kovaçi me një frymë. Ai mbylli derën dhe na

vështroi me sytë e tij që na frikësonin. Mori leckën dhe nxori një revole të re. Ne u çuditëm. Ç'i duhej kovaçit revolja?

— Ju lumtë, çuna! — tha me zërin e ngjirur dhe na përkëdheli flokët. Pastaj u zhduk aq shpejt, sa ne u çuditëm. Dëshëm ta pyesnim përse i kishte sytë të kuq. Ne gjithmonë i kishim pasur frikë ata sy. Rrinim si të shastisur, gjersa erdhën ata të përtejdetit.

— Ç'doni këtu? — tha njëri.

— Sëpatën — tha Vehbiu me gjysmë zëri.

Na nxorën jashtë. Vrapuam drejt në shtëpi siç na kishte porositur miku ynë.

¶Pasdite pazari u lirua.

U mblodhëm të gjithë bashkë dhe u nisëm për te fotografi. Donim ta pyesnim për shumë gjëra. Ç'i duhej revolja kovaçit dhe pse ishte kjo rrëmujë në pazar. Ç'kërkonin ata të përtejdetit?

Nëpër shesh qenë shpërndarë kosha zarzavatesh dhe vezë të thyera. Ne mblodhëm ca mollë dhe, duke i kafshuar, shkuam te baza jonë. Nuk donim t'u besonim syve, kur pamë «lejlekun» me këmbë të thyera dhe copën e kuqe në mur, të shqyer. Miku ynë s'shihej gjëkund.

Mblodhëm copat e «lejlekut» që bënte çudira dhe i çuam në shtëpi, duke menduar për ato që po ndodhnin. U hidhëruam shumë për mikun tonë që nuk po dukej.

Pas ca ditëve baballarët na thanë se fotografi plak ndodhej në burg.

— Përse? — i pyetëm.

— Me siguri kot. Ai ishte njeri i mirë — na thanë.

— Ai ishte miku ynë.

— Po — thanë prindërit.

— Po përse njerëzit e mirë i futin në burg?

Ata heshtën. Ne ishim të vegjël dhe s'duhej të dinim më tepër. Por një ditë bakalli u gjend i vrarë në mes të rrugës. E kishin vrarë, sepse qe spiun. Po kush e vrau? Njerëzit nuk dinin gjë për këtë.

Vetëm ne, miqtë e fotografit, dinim diçka. Me siguri e kishte vrarë kovaçi. E kishte vrarë me revolen e mikut tonë dhe na bëhej zemra mal. Por miku ynë gjendej në burg.

Bridhnim nëpër rrugicën e shtrembër, duke prietur, por ai nuk erdhi. Bota jonë e vogël u zgjerua. Ca gjëra i kuptuam edhe kur s'na thanë të tjerët. Nuk ëndërronim më për kuaj të bardhë, por për fotografin plak. Ata të përtejdetit e mbanin në burg mikun tonë që e deshëm aq shumë.

Tani pyesim vetëm fëmijërinë tonë.

JONA

Përnjëheresh i zuri veshi një zhurmë të çuditshme, sikur një njeri të shkiste me ski mbi borën e ngrirë.

Mendimi i fundit që kishte në kokë ishte gëzimi që do të ndjente nëna plakë, sikur papritur t'ia paraqiste Jonën si të fejuarën e tij. Ç'lumturi! Mirëpo kjo qe vetëm një ëndërr. Ishte e dyta herë që udhëtonte me Jonën. Kur desh të pyeste për diçka, ndjeu rrotat që xhironin. I dha gaz, por pa dobi.

Një pjesë e rrugës shkau lehtë, me gjithë maqinën. Parakolpi u përplas pas një peme të vogël që u thye shumë shpejt.

Nesti fiku maqinën, e cila u trondit dhe qëndroi e mënjanuar rrëzë drurëve të mëdhej që zinin tërë shpatin. Shoferi pa në krahun e tij përmes dritares, por nuk kishte asnjë rrezik, pasi drurët e mbanin maqinën për mrekulli. Mirëpo Jona e kishte humbur fare dhe qe anuar nga shoferi, pa e kuptuar se ç'po bëhej. Nesti ndjeu mbi fytyrë flokët e saj të butë që formonin bukle dhe sapo ktheu kokën, pa fare pranë dy buzë ngjyrë tërndafile.

I dehur nga fryma e saj e ngrohtë, ia mbështolli kokën me duar, duke harruar fare se varej në hum-

nerë. Ai ishte krejt i magjepsur, madje i dukej së maqina varej diku në një hapësirë të madhe lumturie dhe s'mund të gremisej kurrë.

Jona vuri duart në gjoksin e tij dhe e shtyu me forcë. Qe gati të zihej me të.

— Qenke i çuditshëm — i tha ajo, duke rregulluar flokët.

Shoferi uli kokën mbi timon, se nuk kishte guxim ta shihte në sy.

Jona mezi gjeti dorezën dhe, pasi hapi derën e kabinës, doli jashtë. Dritat e maqinës ndriçonin drurët e pyllit që shtrihej në shpatin e pjerrët të malit. Para syve të saj shkisinin me të madhe fletët e drurëve që, duke u zhytur në dritat e verdha të maqinës, dukeshin si flutura të mëdha.

Ai e kuptoi se vajza nuk donte të rrinte pranë tij, sepse e kishte treguar veten të pabesë, këtu në mes të maleve dhe natën.

Ai u deh nga bukuria, por kjo nuk do të thoshte se nuk e donte këtë vajzë. A nuk ëndërroi para pak kohe që ta kishte grua?

Iu kujtua se varej me maqinën në drurët e pyllit shekullor. Zbriti. Maqina vetëm sa qe gërvishur pak në parakolp, ndërsa spondit i qenë thyer dy dërrasa. Maqina nuk mund të shkiste më tej dhe goditjet qenë pa rëndësi. Kishte shkarë një pjesë e rrugës. U çudit kur pa se pak rrugë qe shembur, madje aty mund të kalonin përsëri maqinat.

Errësirë. Jona dhe ai shihnin siluetat e njëri-tjetrit, pastaj u ulën por në anë të ndryshme të rrugës. Tutje, përmes hapësirës së errët, filloi të shpërndahej një njollë e verdhë që sa vinte zmadhohej. Në sytë e Jonës nuk dukej një njeri besnik.

Pastaj ktheu kokën nga ajo. Jona qe ulur mbi një gur dhe diç shikonte në hapësirë.

— Shpëtuam — foli ai pa kthyer kokën.

Jona nuk i ktheu përgjegje. Por nuk mendonte keq për shoferin. Po të qe i tillë, do të vërsulej si një bishë. «Është gjaknxehëtë dhe ai vetë e pranoi. Mbase tani mallëkonte veten se përse e bëri këtë». Edhe asaj nuk i kujtohej mirë se si u ndodh në kra-hët e tij, ndonëse faji qe i dheut që shkau. Një shkarje e tillë nuk duhej të ndodhte, por ja që ndodhi. Ilaçet nuk shkuan në lokalitet, maqina shkau dhe ai e puthi.

— Mërdhin? — e pyeti ai.

Ajo nuk iu përgjegj prapë.

Nesti psherëtiu lehtë dhe e pyeti përsëri.

— Sonte duhen ilaçet në lokalitet?

— Duhet! — foli më së fundi ajo.

— Të presim se mos të vijë ndonjë maqinë.

— Mirë.

Jona u ngrit dhe iu afrua maqinës. Shoferi e kuptoi se ajo ndjente të ftohtë.

— Rri në kabinë — tha ai.

— Jo! — tha ajo e vendosur.

— Rri, Jona! Mos ki frikë. Po deshe, mbylli dyert nga brenda.

Jona hyri në kabinë, mbylli dyert dhe fiku dritën e brendshme.

Desh të flinte, por më kot, se gjumi nuk do ta zinte tërë natën.

Nesti lëvizi disa herë në karroceri, pastaj nuk u ndje më. Edhe Jona mundohej të mos bënte zhurmë.

«Mbase fle, mendoi ajo... Megjithatë nuk është djalë i keq. Ndoshta e bëri sepse i pëlqej. Fundja çdo

djalë ka guximin të puthë vajzën që ka në zemër. Mbase ai më do. Po. Ai me siguri më do mua, ndryshe...»

Hëna u ngrit lart përmes hapësirës mavl, duke zbehur vezullimet e largëta të yjeve. Një qetësi e akullt mbretëronte në pyll.

Ajo mendonte.

Në fshat e prisnin, ndërsa ajo rrinte në kabinën e «Zisit» të rrëzuar. E pra fshati nuk qe aq larg, po t'i bije përmes pyllit.

Jona u drodh? Iu kujtuan lotët e ngrohtë që rridhnin nga sytë e bukur të Nezit me një dhembje të thellë.

Nezi priste me padurim ardhjen e veterineres me ilaçe, mbasi në këto çaste ndonjë nga të tri lopët e sëmura mund të ngordhte.

E përse? Vetëm për një shkarje të lehtë të rrugës të shkonte dëm ajo pasuri? Jo! Lopët nuk duhej të ngordhnin. Dësh të zbriste, por, sapo iu kujtua shoferi, u mblodh kruspull. Kishte frikë. Po sikur ai të sillej keq? Diku dora i preku diçka të ftohtë. Pincë. Më vonë ndjeu t'i vërshonte në trup forca. Hapi derën e kabinës dhe, si zbriti lehtë, u nis nga spondi i prapmë.

Ndenji pak kohë më këmbë, pranë spondit, dhe ndjeu në fytyrë një rrymë të freskët ajri si një cipë akulli. Përmes kësaj ftohtësie me lagështirë pylli vinte fërshëllima e lehtë e gjetheve. Gjithë hapësira ishte mbuluar me dy ngjyra të trishtuara, të verdhë dhe të zezë. Madje, poshtë pemëve krijoheshin si-
lueta të pakuptueshme që të shtinin frikën.

Spondi qe i mënjanuar dhe ajo mezi shikonte brenda karrocërisë së mbuluar me mushama.

Nuk dëgjonte as zhurmën më të vogël. Ndoshta ai flinte dhe ajo nuk donte ta zgjonte. Megjithatë, mori guxim, dhe, duke u ngritur në majë të gishtërinjve, thirri lehtë:

— Zgjohu!

Nga buzët e Jonës fjala doli aq e butë, si një mërmëritje përmes fletëve.

Në karroceri asgjë nuk pipëtinte.

— Shofer! Zgjohu! — thirri ajo me zë më të vendosur.

Përsëri heshtje.

Jona mendoi të kthehej në kabinë, mirëpo duhej të shkonte në fshat. Përsëri iu kujtua mërzitja e stallieres së kooperativës.

— Nesti!

Pastaj dikush lëvizi.

Ajo pa kokën e shoferit që doli mbi spond.

— Flije? — e pyeti ajo.

— Jo!

— Përse nuk u përgjegje?

Ai heshti duke vështruar vajzën.

Pastaj u hodh nga spondi në tokë.

Maqina u lëkund, ndërsa zhurma e këmbëve të tij u përhap pyllit.

— Do të vemi në fshat! — tha ajo me zë të sigurt.

— Mirë, Jona.

— Ndoshta lopët ngordhin.

— Lopët?!

— Po — tha ajo.

Errësira e mbulonte më së miri maqinën e rrëzuar, megjithatë ai mblodhi një krah të madh degësh dhe i hodhi në kabinë. Dritat i kishte fikur. Për ca çaste e vërejti maqinën nga rruga dhe që atje thirri sikur t'i fliste dikujt shumë larg.

— Nuk duket fare.

Jona priste më këmbë.

— Nisemi — i tha ajo.

Një pjesë të rrugës e kaluan krah për krah, mirëpo pastaj, si u futën në një rrugë këmbësore të ngushtë, ai eci përpara, ndërsa ajo pas. Rrugës shihnin vetëm silueta të palëvizshme trungjesh pylli Me të kaluar lirishtën, iu ngjitën një shpati që i lodhi shumë. Sa herë që shkisinin, mbaheshin pas degëve të dushqeve dhe ndihmonin njëri-tjetrin.

Diku u ndalën. Ai dëgjoi gurgullimën e lehtë të një burimi që duhej të nxirrte shumë ujë. U ulën. Përmes kurorave të larta të drurëve, hëna ndriçonte një shesh të vogël ku ndodheshin arka të stivosura njëra mbi tjetrën. Dukeshin si arka frutash. Trarët e mëdhenj të ngulur në tokë tregonin se këtu kishte qenë një barrakë. Nesti u çudit. Pasi pinë ujë, u ulën pranë arkave.

— Mërdhin? — e pyeti ai.

— Pak — iu përgjegj ajo me gjysmë zëri.

— E di ç'ke, merr xhakaventon time.

Jona kundërshtoi, por ai ia hodhi krahëve. Duke ndjerë ngrohtësinë e xhakaventos së shoferit, iu duk se harroi mërzitjen që kishte pak më parë.

— Këtu kanë qenë sondat — tha ajo.

— Sondat?

— Po. Kërkuan mineral pranë atij përroi.

— Si quhet? — e pyeti ai.

— Skatinë.

Pastaj u ngritën dhe dolën në një rrafshinë me shkurre, prej ku dukej një grumbull dritash.

— Janë dritat e fshatit — tha ajo, ndërsa shtrëngonte çantën prej meshini ku mbante ilaçet.

— Sa bukur! — tha shoferi, ndërsa vështronte tutje në shpatin e pjerrët të veshur me bulëza drite.

— Vërtet është bukur — tha ajo, ndërsa i regë-tinte zemra nga një ndjenjë e thellë gëzimi.

S'do ta harronte kurrë këtë mbrëmje, as flokët dhe as vrazhdësinë e syve të Nestit që menjëherë larushiteshin me ndjenja lumturie.

Ai e vështronte Jonën vjedhurazi. Ari i hënës dhe era loznin me flokët e saj të valëzuar. I vinte t'i përkëdhelte ato flokë. Po vetëm e shihte duke ëndërruar.

Gjithmonë e kishte ndjerë se vajzën e zembrës do ta gjente në udhëtim. Kur para një muaji Jona kishte udhëtuar me të, e kishte kuptuar se kjo duhej të qe. Tani udhëtonte përmes pyjeve dhe errësirës me ëndërrën e tij të bukur.

Jona mendonte ndryshe. Para një viti kishte ardhur veterinerë në këtë krahinë të largët. I kishte ndodhur një fatkeqësi. Mirëpo ajo u thoshte shoqeve se më mirë që i kishte ndodhur kështu dhe jo ndryshe, pasi tani kishte fituar lirinë për të jetuar si të gjitha vajzat dhe gratë.

— Po ti? — e pyeti papritur Nesti.

— Çfarë?

— Je e fejuar?

Ajo nuk u përgjegj.

— Përse nuk flet, Jona?

Ajo, edhe pse kishte hedhur mbi shoferin një shikim të çiltër, nuk donte t'i tregonte asgjë nga jeta e saj. E përse? Në jetë mund të takosh shu. lloj njerëzish dhe ajo kishte pasur fatin e keq të takohet dikur me një prej atyre që nuk duken të këqij në pamje, por e vërteta e tyre qëndron brenda shpirtit. Ajo e kishte njohur vonë atë njeri dhe për këtë gaboi rëndë. Dhe përse t'i tregonte shoferit, kur akoma nuk ishin njohur mirë? Sikur ta merrte vesh, si do të sillej me të? Jo. Mjafton kaq. Një njohje e bukur në rrugë, një puthje e rrëmbyer dhe asgjë. Kushedi se kur i bie rruga të vijë në këtë fshat të largët. Mbase kurrë.

Kishin vetëm edhe disa metra për të hyrë në fshat. Herë pas here lehnin qentë.

— Përse nuk tregon?

— Unë?

— Po.

— Më quajnë Jona.

— Dhe tjetër asgjë?

— Asgjë.

Ai donte t'i thoshte se e dashuronte, mirëpo diku larg dëgjoji zëra në errësi.

— Hej! — thirri ai duke vënë duart në gojë si bëri.

Një grup fshatarësh me fener, që nuk qenë shumë larg, thirrën:

— Kush jeni ju, more?

— Jam veterinerja — tha Jona me zërin e saj të hollë që jehoi deri larg.

Ajo pa shkollën mbushur me dritë plot, prej së cilës dolën ca vajza që zunë ta thërrisnin me emër. Qenë brenda në fshat.

Jona desh të nisej me vrap drejt shoqeve, por ai e mbajti.

— Një vajzë si ti nuk duhet t'i harrojë bashkudhëtarët.

— Kush tha se i harroj?! — tha ajo duke e shikuar në fytyrë.

Pastaj zgjati dorën në errësirë drejt tij.

— Pincë! Ku e gjetët?

— Në kabinë — tha ajo duke buzëqeshur.

— Ti ke menduar keq — u inatos Nesti.

Jona tundi kokën. Vështronte sytë e tij dhe ndjeu diçka të ngrohtë që i vërshoi në kraharor.

— Ne duhet të takohemi përsëri — tha shoferi.

Nuk mori përgjegje. Jona rrinte drejt, përballë tij, ndërsa një dritë e argjendë herë i binte në fytyrë dhe flokët ia valaviste era sa andej-këtej.

— Jona! — tha ai.

Vajza u lëkund si një pemë që i kanë prekur rrënjët dhe u zhduk në errësirë.

Ai dëgjoji vetëm një zë të butë dhe të ngrohtë që vinte nga largësia e drurëve.

— Lamtumirë, Nesti!

— Përse lamtumirë? Mirë u pafshim, Jona!

— Do të rrish sonte? — e pyeti shoferin një fshatar që mbante fenerin.

— Kam maqinën me mall në rrugë.

— Epo mirë. Përcille ti, Ndue, se në po shkojmë në shtallën e lopëve. Natën e mirë, shofer!

Nesti dhe fshatari u nisën. Feneri dukej si një xixëllonjë e stërmadhe që lëvizte nëpër pyll. Shoferi ecte duke i premtuar vetes se do të kthehej përsëri në fshatin e largët për t'u takuar me Jonën.

Disa herë ktheu kokën. Dritat që vezullonin dhe

lehjet e qenve humbnin përmes largësive dhe drurëve.

Kishin hyrë në rrugën e pyllit. Një erë e lagët frynte përmes gjetheve që fëshfërinin lehtë dhe tektuk rrëzoheshin në errësirë. Qe fillim vjeshte. Mërdhiu pak, pastaj u kujtua dhe veshi xhakaventon që mbante në dorë.

Qielli mavi u bë krejt i kaltër.

Nesti shikonte yjet e hënën e venitur që shkiste lehtë, ndërsa përmes xhaketës, ndjente ngrohtësinë e vajzës veterinerë me emrin e bukur Jona.

PASQYRA E LËNDËS

	Page
Petalet e bajames së hidhur	3
Plaku	13
Italiani Domeniko	19
Drojtje	31
Mjellma e gurores	40
Ndanë qytetit	45
Brigadieri i vjetër	52
Fëmijni e çuditshme	58
Jona	66